

RAPORT  
2002



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**

**KKRT – KESHILLI KOMBETAR I RADIOS DHE TELEVISIONIT**

Rruga: “ Abdi Toptani, Tirane.

Tel ( 0035542) 333 26

Fax ( 0035542) 262 87

E-mail: [kkrt@kkrt.gov.al](mailto:kkrt@kkrt.gov.al)

Nr. 111 prot.

Tirane, me 04.02.2003

**LENDË:** Dergohet materiali per raportim ne Kuvend

**KUVENDIT TE SHQIPERISE**

**Komisionit te Perhershëm per Mjetet e Informimit Publik**

z. Musa ULQINI, Kryetar

**Tirane**

Ne pergjigje te shkreses tuaj nr. 9, date 08/01/2003 bashkelidhur ju dergojme “Raportin mbi veprimtarine e KKRT per vitin 2002”.

**KRYETARI**

**Sefedin ÇELA**

## KKRT – 2002

1. Raport vjetor ne Kuvendin e Shqiperise
  - Hyrje, faqe 1
  - Programet: monitorimi, e drejta e transmetimit, pirateria, faqe 2 – 8;
  - Keshilli i Ankesave, faqe 9 – 10;
  - Administrimi i Frekuencave, faqe 11 – 21;
  - Realizimi i buxhetit – 2002, detyrat per vitin 2003, detyrimet e operatoreve rtv, faqe 22 – 28;
  - Konkluzione, faqe 29 – 31;
2. Plani i Veprimit – 2003.
3. Pasqyra (nr.1) e detyrimeve te operatoreve private rtv per vitin 2002.
4. Pasqyra (nr.2) Gjobat.
5. Mbulimi i operatoreve rtv deri ne fund te vitit 2002 (ne harte).
6. Pasqyra “ Operatoret private rtv ne funksionim, Te dhena teknike, statistikore. (Aneksi1).
7. Gjendja e mbulimit te territorit te Shqiperise me sinjal radio FM e TV deri ne fund te vitit 2002. (Aneks2)
8. Frekuencat e okupuara nga operatoret radio e televizive ne territorin e Shqiperise.(Aneks 3)
9. Stacionet transmetues radio FM (Pasqyra).
10. Stacionet transmetues tv (Pasqyra).
11. Pasqyra e ceshtjeve gjyqesore per vitin 2002.
12. Pasqyra e paralajmerimeve te dhena nga ana e KKRT-se se subjekteve, ne lidhje me shkeljet e konstatuar.

# KKRT – 2002

## - Raport vjetor ne Kuvendin e Shqiperise -

### 1. Hyrje

Viti 2002 shenon nje kthese ne veprimtarine e Keshillit Kombetar te Radios dhe Televizionit. Ky eshte viti i kalimit nga **gjendja e emergjences**, permes kapercimit te kaosit, drejt nje veprimtarie te rregulluar, duke filluar me sjelljen e operatoreve radio e televizive brenda kornizave te pergjithshme ligjore ekzistuese. Aktualisht jemi ne **fazen e konsolidimit** te veprimtarise rtv dhe te vete institucionit, afirmimit te rolit te tij ne rregullimin e transmetimeve radio e televizive, integrimin ne strukturen e pergjithshme te shtetit nepermjet vendosjes se lidhjeve te qendrueshme institucionale, kualifikimit te personelit dhe modernizimit te mjeteve dhe instrumentave te domosdoshem per mbeshtetjen e veprimtarise.

Operatoret e licencuar tashme e njohin rolin e KKRT dhe, me disa perjashtime, kane filluar t'i respektojne detyrimet e ligjit dhe kushtet e licences.

KKRT ka stabilizuar raporte institucionale me organizmat e shtetit, si dhe me organizma nderkombetare te specializuara.

Ne krahasim me fillimin, tashme personeli i administrates se KKRT ka fituar eksperiencen e duhur per sektoret qe mbulohen respektivisht. Per kete kane kontribuar edhe trainimet e organizuara si brenda e jashte vendit dhe pjesmarrja ne aktivitetet me teme rregullimin e transmetimeve radio e televizive, te organizuara nga organizma te specializuara ne nivel boteror, europian e rajonal, si EPRA, EBU, ITU, ERO, apo nga donatore e realizues projektesh si Mbretaria e Danimarkes (Projekti DANIDA, etj).

Tashme, ne saje te mbeshtetjes nga buxheti i shtetit e posacerisht te donatoreve nderkombetare (DANIDA, OSBE, IREX), KKRT disponon nje **studio** bashkekohore **per monitorimin e programeve**, nje **Qender** moderne **te Levizeshme per Monitorimin e Frekuencave** te pajisur me fjalen e fundit te teknikes si dhe programet dhe hardware-in perkates per te kryer te gjitha matjet e llogaritjet e komplikuara qe kerkon mbikqyrja e zbatimit te ligjit dhe kushteve te licences nga operatoret radio e televizive.

Viti 2003 eshte kyç per veprimtarine rtv: Nje plan veprimi i detajuar, si pjese e ketij raporti, konsiderohet domosdoshmeri per mbarevajtjen e veprimtarise radiotelevizive.

Miratimi i Planit te frekuencave, sipas Hartes se Frekuencave per Transmetime Rtv, produkt i Memorandumit te Mirekuptimit midis KKRT, OSBE-se, IREX dhe DANIDA – s, te cilen tashme e kemi ne duar, amendimi i disa neneve ne ligjin “ Per radion dhe Televizionin publik e privat ne Republikën e Shqiperise” si dhe hartimi i disa procedurave te reja per procesin e metejshem te licencimit do te e cojne punen ne teresi ne nje faze cilesisht te re dhe veprimtarine rtv sa me prane standarteve bashkekohore e ne perputhje me ligjin.

## 2. Programet : monitorimi, e drejta e transmetimit, pirateria

Shpejtesia e rritjes se mozaikut te medias elektronike, beri qe problemet ne fushen e programeve, si edhe ne fushat e tjera, te grumbullohen dhe te paraqesin veshtiresi per tu zgjidhur.

Drejtimet kryesore te punes se KKRT-se gjate vitit 2002, ne fushen e programeve u perqendruan kryesisht ne:

- Monitorimin e programeve informative te operatoreve kombetare.
- Transmetimi ne gjuhen shqipe, duke respektuar ligjin dhe kushtet e licenses.
- Respektimi i te drejtave te transmetimit, pirateria.
- Monitorimi i funksionimit ligjor ne transmetimin e reklamave.

Per permbushjen e ketyre objektivave , gjate vitit 2002 u ngrit Qendra e Minitorimit te Programeve, nje investim prej 15 milion leke i KKRT-se. Nepermjet kesaj qendre mbikqyret funksionimi ligjor i operatoreve radiotelevizive ne pergjithesi dhe posacerisht ajo i sherben monitorimit te programeve informative te transmetuesve kombetare.

Sistemi kompjuterik i instaluar eshte ne gjendje te monitoroje dhe te regjistroje ne kohe reale te pakten 20 kanale televizive dhe 10 kanale radiofonike. Informacioni i grumbulluar ne 24 ore merret ne menyre elektronike dhe mund te perpunohet nga specialistet ne 10 vende pune. Nga ky perpunim krijohen raporte statistikore periodike per vleresimin e operatoreve radiotelevizive.

KKRT, ka ndjekur ne vazhdimesi transmetimin e edicioneve informative te operatoreve kombetare, bazuar ne nenin 7/2 te Ligjit Nr.8410 date 30.09.1998 "Per Radion dhe Televizionin publik dhe privat ne RSH".

Per kete arsye u monitoruan edicionet kryesore te lajmeve te Televizionit SHQIPTAR, Televizionit KLAN dhe Televizionit ARBERIA, duke filluar nga muaji Shkurt 2002 e ne vazhdim.

U zgjodhen per monitorim vetem edicionet qendrore te lajmeve, duke presupozuar se te dhenat e nxjerra jane te barasvlefshme edhe per edicionet e tjera informative. Ne pergjithesi ruhet e njejta strukture lajmesh ne edicione te ndryshme te te njejtit transmetues.

Rezultatet e monitorimit u jane derguar operatoreve televizive kombetare te monitoruar, si dhe Komisionit Parlamentar te Medias, institucioneve nderkombetare qe merren me problemet e medias ne vendin tone etj. Eshte per tu theksuar se, TVSH dhe TVA e vleresuan monitorimin dhe e pasqyruan metodiken dhe rezultatet e tij, ne tere edicionet e lajmeve. Kurse Tv KLAN nuk iu pergjigj praktikes se homologeve te vet dhe nuk ka shprehur vleresimin per kete monitorim.

Procedura e monitorimit konsistonte ne percaktimin e statistikave per te dhenat si: TEMA (politika, ekonomia, kronika e zeze, veprimtaria e qeverise dhe parlamentit, arsimi , shendetesia etj); AKTORI KRYESOR (Presidenti, Kryeministri, Partite Qeverisese. Partite Opozitare, qytetare protagoniste etj); AKTORI SINKRON dhe SUBJEKTI SINKRON.

Televizioni shqiptar ne pergjithesi ka qene i drejte dhe i paanshem ne informimin e publikut. Eshte ruajtur parimi, qe edicionet informative te mos i sherbejne ne menyre te njeanshme interesave te asnje partie apo organizate politike, grupimi ekonomik dhe komuniteti a shoqate fetare. Ne raste te vecanta perkrahen jo profesionalisht grupime te caktuara politike. Informacioni ka qene i shumellojshem si politik, kulturor, social-ekonomik, sportiv etj.

Tema kryesore ne edicionet informative ne TVSH ka qene POLITIKA, duke zene mesatarisht 20% te kohes se lajmeve.

Eshte permiresuar nga njeri muaj ne tjetrin, raporti i kohes ne dispozicion te Partite Qeverisese me Partite Opozitare.

Pavaresisht nga raportet e drejta, verehet se politika ze vend ne informacion edhe per probleme qe nuk perbejne lajm, aq me teper per nje transmetues publik.

Ne programet informative te televizionit KLAN, eshte respektuar parimi dhe kerkesa ligjore, per paanesine e informacionit ne lidhje me partite politike, por nuk eshte respektuar gjithmone ky detyrim, per grupimet politike brenda te njejtes parti. Faktet dhe ngjarjet jane pasqyruar ne menyre te drejte.

Sot ne Shqiperi shume nerez e ndjekin TV KLAN per te qene te mireinformuar rreth nje problemi te caktuar. Informacioni ne TV KLAN shoqerohet me qendrim, apo thene ndryshe, me koment per ngjarje te rendesishme kombetare dhe nderkombetare.

Tema kryesore ne lajmet e TV KLAN ka qene POLITIKA, duke zene 23% te kohes.

Partite Qeverisese kane patur ne dispozicion te njejten kohe me Partite Opozitare.

Edicionet informative te TVA, jane ndoshta programet me te realizuara nga ky kanal televiziv. Lajmet e transmetuara ne edicionet informative respektojne parimin e paanesise dhe paraqitjes se drejte te fakteve. Publiku ndjek keto edicione ne TVA, i bindur ne vertetesine e lajmeve te transmetuara. Tematika e informacionit eshte e larmishme.

Tema kryesore ne lajmet e TVA ka qene POLITIKA, duke zene perkatesisht 21% te kohes .

Partite Qeverisese kane patur ne dispozicion te njejten kohe me Partite Opozitare.

Ne pergjithesi edhe radiot kombetare si Radio Tirana, "Radio +2" dhe "Top Albania Radio" transmetojne programe informative duke zbatuar kerkesat e ligjit dhe normat profesionale. Pavaresisht nga karakteristikat e ndryshme te organizimit te edicioneve informative ne keto Radio, ato ndiqen me interes dhe kane fituar besueshmerine e publikut.

E njejta gje mund te thuhet jo vetem per lajmet, por edhe per emisionet nga aktualiteti, qe transmetojne apo kane transmetuar opeatoret rtv kombetare, si "OPINION", "DEBAT", "360 grade- Rruzulli mediatik", "DRITARE" etj

Perfundimisht mund te themi se, **transmetuesit kombetare funksionojne sipas kerkesave te ligjit ne fushen e programeve informative.**

**Kete perfundim te rendesishem mund ta themi per pjesen me te madhe te programeve informative te transmetuara nga media elektronike. Roli pozitiv i saj ne informimin e publikut eshte tashme i padiskutueshem.**

Kur nxjerrim kete perfundim, kemi parasysh programet informative te "Vizion +", "Shijak TV", "Top Channel", "Tv Koha", TNSH, "Egnatia TV", "Tv Kombi", "Tv 6+1", "Tv Teuta", "Adriatik TV", "Tv 4+" si dhe shume televizione e radio ne gjithe territorin e vendit.

Licensimi i nje numri kaq te madh transmetuesish dhe vleresimi i lirise se shprehjes dhe informimit, si nje nga shtyllat e shoqerise demokratike dhe pluraliste, jep nje pafundesi mundesirash per perhapjen e informacionit dhe shprehjen e ideve dhe opinioneneve.

KKRT eshte perpjekur te respektohet ligji, i cili perjashton censuren dhe çfardo lloj tjeter kontrolli, vetekontrolli dhe shtrengimi arbitrar ne procesin e perhapjes se informacionit, por qe percakton standarte.

Mund te kete me dhjetra raste per te penalizuar operatore te ndryshem per informacion te pasakte, per mungese etike profesionale ose per agresivitet te tepruar. KKRT eshte mjaftuar me terheqjen e vemendjes dhe detyrimin per pergenjeshtim, si kerkese e ligjit. Kemi mendimin se çdo sanksion tjeter ne fushen e informimit, mund te politizohet ne menyre te skajshme.

Nje nga problemet kryesore qe ka ndjekur KKRT gjate vitit 2002 eshte zbatimi i ligjit ne fushen e transmetimit te programeve ne gjuhen shqipe.

Ne nenin 37 te Ligjit nr. 8410 date 30.09.1998 midis te tjerave thuhet, se perdorimi i gjuhes shqipe eshte i detyruar per te gjitha programet... dhe se filmat ne version origjinal ne tv kombetare transmetohen te shoqeruar me subtitrim dhe(ose) dublim ne gjuhen shqipe. Per ...televizionet lokale ky detyrim fillon te zbatohet nje vit pas licensimit.

Kjo kerkese ligjore eshte zbatuar nga operoret kombetare dhe nje pjese e televizioneve vendore. Pjesa tjeter e operatoreve vendore e anashkalonte kete kerkese te ligjit. Prandaj KKRT vendosi te kryhet monitorimi i programeve te gjithe televizioneve, me qellim respektimin e kushtit ligjor per transmetim ne gjuhen shqipe. Deri ne fund te tetorit u krye monitorimi programeve televizive te operatoreve, sinjali i te cileve duket ne Tirane. Ne fund te vitit perfundoj monitorimi i pothuajse te gjitha televizioneve te tjera.

Mbi bazen e rezultateve te monitorimit, me Vendimin Nr.124, dt. 31.10.2002, KKRT vendosi reduktimin e kohes se licenses per televizionin Junior nga 5 ne 3 vjet, si dhe reduktimin e kohes se licenses nga 5 ne 4 vjet, per televizionet Calvin dhe Nesar tv.

Gjithashtu me Vendimin nr.123 dt 31.10.2002, eshte vendosur sanksioni i paralajmerimit per reduktim te kohes se licenses, per dhjetra operatore te tjere televizive, qe kane shkelur ligjin ne fushen e gjuhes se perdorur ne transmetimin e programeve.

Po me ane te ketij vendimi te KKRT-se, paralajmerohen te gjithe operoret televizive te nderpresin ritransmetimin e programeve duke u lidhur direkt me kanalet satelitore, qofte edhe ne oret e vona te mbremjes.

Pas sanksioneve te vendosura dhe presionit ligjor te ndermarre, ka pasur permiresime te ndjeshme dhe perpjekje te vazhdueshme per respektimin e ligjit. Theksojme qe kjo pune do te vazhdoje edhe ne te ardhmen.

Pa dashur te vleresojme arritjet e deritanishme te medias elektronike, e ndejme te nevojshme te evidentojme disa nga programet dinjitoze te operatoreve radiotelevizive gjate vitit 2002.

Ketu permendim:

- Telenovelen “Njerez dhe fate” ne TVSH
- Spektaklet e Tv Klan , “Maratona e kenges popullore”.
- Spektaklet “RoCoCo”, “Kenga Magjike” ne Tv Arberia.
- Serialin “Tunel” te filmave dokumentare dhe konkurset “Quiz+” ne “Vizion +”
- Programet “Shqip” dhe “Fiks Fare” ne Top Channel”.
- Emisionet per femije dhe ciklin “Forum” ne Tv Shijak
- Emisionet e larmishme sportive dhe problemore ne Telesport.
- Programin “Kaleidoskop” dhe “ Pegaso” ne TNSH
- Emisionin “Çeshtja eshte ...” ne Tv KOHA

e dhjetra programe te tjera te prodhuara vete nga operoret e licensuar, qe jane shprehje e pasionit, profesionalizmit dhe perpjekjeve gjithnje ne rritje per realizime te suksesshme.

Pirateria eshte problemi me i mprehte dhe me delikat ne fushen e veprimtarise radiotelevizive. KKRT e shikon kete si nje tranzicion te zgjatur e te veshtire, si nje process qe duhet perballuar, sipas ligjit, jo me sanksione drastike administrative thjesht e vetem nga KKRT-ja, por si konflikt midis paleve, duke mbrojtur ne rruge gjyqesore secili te drejten e vet.

Periudha e pare e licensimit po perfundon. Shume shpejt vjen koha e rinovimit te licensave. Asnje license nuk do te rinovohet per ata operore qe kane mbijetuar duke piratuar. Jane disa arsye qe na shtyjne te tregohemi te matur ne heqjen ose jo te licensave, per ata operore qe vazhdojne te piratojne programe.

1. Ligji nuk parashikon heqjen e licensave per radiotelevizionet qe e praktikojne piraterine. Ndryshe nga shume vende te tjera, per kete fenomen ne ligjin tone nuk parashikohen as gjoba, si nje mase qe mund te minimizonte fenomenin. KKRT ka bere propozimin per amendamente ne ligj, ku parashikohen sanksione per piraterine radiotelevizive.
2. Ligji parashikon qe problemet e piraterise, te drejtes se autorit dhe te drejtave te transmetimit te zgjidhen me gjyq. Pra ka nje pale te demtuar qe ankohet se i jane shkelur keto te drejta dhe nje pale te akuzuar si shkelse e te drejtave te transmetimit. Deri tani subjekte shqiptare televizive kane mbrojtur nepermjet mediave te tyre, te drejtat e transmetimit te gjigandeve televizive boterore te piratuar nga media elektronike shqiptare, pasi ne raste teper te vecanta jane shkelur te drejtat e transmetimit te zoteruara nga vete operoret shqiptare. Eshte fakt qe ndryshe nga nje vit me pare, sot subjektet radiotelevizive vleresojne dhe jane te gatshem te respektojne te drejtat e transmetimit te blera nga homologet shqiptare. Permendim,
  - Te drejten e transmetimit te Kampionatit Boteror te Futbollit 2002 nga TVSH dhe Telesport.
  - Te drejtat e transmetimit te Top Channel per ndeshjet e kampionatit anglez dhe spanjoll te futbollit

- Te drejten e transmetimit te garave te Formula 1 ne Automobilizem nga Top Channel
  - Te drejten e transmetimit te Kampionatit Italian te futbollit nga TVA
  - Te drejten e transmetimit nga Tv Klan per ndeshjet e liges se Kmapioneve te Europes.
  - Te drejten e transmetimit te ndeshjeve te Kampionateve gjerman dhe hollandez te futbollit nga Telesport
  - Te drejtat e transmetimit te telenovelave nga disa kanale televizive dhe te serialit Oktapodi nga Tv Klan
3. KKRT ne çdo rast ka bashkepunuar me operoret radiotevizive per te mbrojtur te drejtat e transmetimit te blera prej tyre. Theksojme qe ne shumicen e rasteve ka gjetur mirekuptim nga operoret e tjere. Interpretimet e ndryshme dhe kontradiktore nga disa media jane pjese e konkurences qe po ashpersohet dita dites.
  4. Mbetet problem çfaqja ne ekran i filmave artistike pa te drejta transmetimi. Por, perveç Albafilmit qe ka depozituar kerkesen per zgjidhjen e kesaj çeshtje, ne KKRT nuk ka ankesa te tjera nga subjektet qe i jane shkelur te drejtat e transmetimit. Me shkresen e dates 19.09.2002 Nr.716/1Prot. KKRT i ofron Studios "Albafilm" dhe "Albafilm Animacion" bashkepunimin ne fushen e mbrojtjes se prones se tyre artistike, duke evidentuar shkeljet per cdo operator, titujat e veprave te piratuara, kontratat qe ata kane lidhur te shoqeruara me kushtet perkatese. KKRT ve ne dispozicion regjistrimet e veta per ballafaqimin me ligjin.
  5. Nje problem i pazgjidhur mbetet pronesia e veprave te Radiotevizionit Publik Shqiptar, qe transmetohen pothuajse nga te gjithë operoret e tjere radiotevizive. Edhe per kete çeshtje mendojme se duhet te behet objekt zgjidhjeje nga gjykata me kerkesen e RTSH-se.

Zbatimi i kerkesave te ligjit ne transmetimin e reklamave u vleresua nga KKRT si nje element i rendesishem dhe i ndjeshem, i ekzistences dhe funksionimit te subjekteve radiotevizive. Ne fund te fundit konkurenca lind per sigurimin e tregut te reklamave. Dhe ne kete konkurrence, vihen re tendenca per t'ju shmangur ligjit. Gjithashtu nuk njihen sa duhet, kerkesat e ligjit si per transmetimin e reklamave ashtu edhe per sponsorizimin e programeve radiotevizive.

KKRT monitoroi transmetimin e reklamave te operoreve televizive gjate muajit gusht dhe shtator 2002. Te gjitha te dhenat ju prezantuan operoreve dhe iu kerkua atyre te zbatojne kerkesat e transmetimit te reklamave. U vu re qe:

- Ka shkelje te ligjit ne nderfutjen e reklamave, sidomos gjate transmetimit te filmave artistike.
- Transmetohen here pas here reklama ne gjuhe te huaj.
- Transmetohen reklama brenda edicioneve te lajmeve.
- Transmetohen reklammat indirekte te produkteve te duhanit.
- Jane transmetuar, duke mos respektuar kerkesat e ligjit njoftimet e sherbimit telefonik me vlere te shtuar.

Tre çeshtjet e para janë zgjidhur me mirekuptim midis KKRT-se dhe operatoreve radiotelevizive.

Dy çeshtjet e fundit janë trajtuar posacerisht nga KKRT-ja, pasi ishin delikate dhe kerkonin interpretim ligjor.

Se pari u ndermor nje fushate e gjere promovimi ne median elektronike i kompanise British American Tobacco. Spoti promovonte kompanine BAT, e indirekt edhe produktet e duhanit. Reklama e pare e BAT dhe nje dokumenatar per te, u pezullua nga KKRT. Ne kushtet qe ne ligj nuk jepej nje perkufizim i reklames indirekte, kompania ne fjale kerkonte te drejten te promovonte biznesin e saj ne Shqiperi. Promovimi i biznesit te kompanive, qe prodhojne ose tregtojne produkte te duhanit, nuk eshte i ndaluar me ligj, gje qe mund te amendohet ne te ardhmen. Por te ketij mendimi nuk ishin Agjencia e Duhan Cigareve dhe Bashkimi i Investitoreve dhe Industrialisteve te Shqiperise. Ne konsultim me ta dhe me Drejtorite perkatese ne Ministrine e Ekonomise, KKRT-ja pezulloi transmetimin edhe te spotit te ri.

Se dyti, KKRT pershendet te gjithë subjektet radiotelevizive ne mirekuptimin e treguar per transmetimin e reklamave. Megjithese ka te beje me sigurimin e te ardhurave, pjesa me emadhe e subjekteve janë korrekte me vendimet e KKRT-se per transmetimin e reklamave dhe sponsorizimet.

Se treti, c njejtë fryme mirekuptimi u tregua nga operatorët edhe ne zbatimin e Vendimit Nr.122 date 31.10.2002 “Mbi disiplinimin e transmetimit te reklamave te sherbimit telefonik me vlere te shtuar dhe reklamave e njoftimeve me titra”. Ky vendim morri shkas nga shqetesimi publik, per shoqerimin e te gjitha programeve televizive me titrat e “linjes 0900...”, duke demtuar ne kete menyre edhe vleren dhe integritetin e programit te transmetuar.

Thelbi i ketij vendimi ishte qe, transmetimi i reklamave te sherbimit telefonik me vlere te shtuar, te behej vetem ne “programet reklame” dhe t’i nenshtrohej te gjitha kerkesave te ligjit per transmetimin e reklamave. Pa mohuar te drejten e kompanise se licensuar, per te reklamuar aktivitetin e saj, vendimi ne fjale mundeson edhe perdorimin e numrave telefonike me vlere te shtuar gjate lojrave telefonike radiotelevizive si dhe ne programet qe komunikohet direkt me publikun. Duhet te pranojme qe keto forma reklamimi nuk janë shpikje shqiptare. Por ne asnje vend tjeter ato nuk janë jashte kontrollit dhe ne liri te plote. KKRT ka propozuar edhe nje amendament ne ligjin egzistues, qe rregullon transmetimin nepermjet titrave te sherbimeve te tilla dhe te reklamave indirekte.

Programet radiotelevizive detyrohen me ligj te respektojne kufizimet e nenit 10 te Konventes Europiane “Per mbrojtjen e te drejtave dhe lirive themelore te njeriut” .

Ne radio dhe televizione, sipas nenit 38 te ligjit, ndalohen te jepen programe... qe nxisin urrejtjen fetare dhe raciale...si dhe informacione qe cenojne jeten private te shtetasve.

Tashme eshte kthyer ne praktike normale e drejta e pergjigjes dhe pergenjeshtrimit, kur ne media preken interesa te qytetareve. Pergjithesisht ankesave te paraqitura ne KKRT, operatorët u janë pergjigjur me korektese, duke u krijuar akses paleve per pergjigje. Por ende standartet profesionale nuk respektohen: perdoren ende fyerje, epitete, per fat te keq edhe nga gazetaret.

Media elektronike publike dhe private, jo vetem ne zbatim te ligjit, por edhe duke respektuar standartet etiko-morale te funksionimit, ndikojne ne luften per mbrojtjen e te drejtave te njeriut.

KKRT ka monitoruar operatoret rtv dhe per standartet e percaktuara ne ligj per respektimin e te drejtave te njeriut, ka evidentuar raste te cenimit te te drejtave te njeriut ne pergjithesi dhe te femijeve ne vecanti. KKRT ka marre masa paralajmeruese ndaj operatoreve televizive qe shkelin standartet e percaktuara ne ligj.

Ne muajin Korrik 2002 me Vendimin Nr.103, KKRT ka hartuar dhe miratuar Rregulloren "Ne lidhje me rregullat e vecanta per transmetimin e programeve radiotelevizive, te cilat mund te demtojne zhvillimin fizik, mendor dhe moral te femijeve". Kjo rregullore eshte mirepritur nga te gjithe operatoret radiotelevizive.

Nga monitorimet, vrojtimet dhe vezhgetimet e perditeshme, nxjerrim perfundimin qe media elektronike gjithmone e me shume po i afrohet standarteve profesionale ne fushen e programeve. Keto standarte jane te arritura ne programet informative.

Me mundesi te tjera financiare dhe kualifikim te metejshem profesional, gjendja do te ndryshoje edhe ne fushat e tjera.

### 3. Këshilli i Ankesave

Një nga drejtimet kryesore të punës së Këshillit të Ankesave organ i pavarur keshillimor, prane KKRT-se, edhe gjatë vitit 2002 ka qenë sensibilizimi i opinionit, për njohjen e institucionit të Këshillit të Ankesave dhe të mënyrës së funksionimit të tij. Gjatë këtij viti nga Këshilli i Ankesave janë realizuar studimet për shenjat paralajmëruese, për dhunën televizive, si dhe janë bërë shkrime të ndryshme ku janë vënë në fokus stacione televizive që kanë qenë problem për mosrespektimin e normave etiko-morale si TVSH, tekstet e Mediatelit të shpërndara në disa stacione televizive etj. Të gjitha këto, së bashku me shkrime të tjera për dhunën televizive dhe përvojën e huaj, janë botuar në 2 numurat e buletinit "Antena" të këtij viti. Tani po përgatitet numri i dhjetorit, ku do të pasqyrohen materialet që i takojnë 6-mujorit të dytë të vitit në vazhdim.

Një nga drejtimet e punës së Këshillit të Ankesave ka qenë testimi i opinionit të publikut të gjerë. Kësaj i ka shërbyer anketimi i dytë pilot, i kryer në bashkëpunim me "Fondacionin për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve dhe të Konflikteve". Në ndryshim nga një vit më parë u zgjerua gjeografia e këtij testimi duke përfshirë në anketim edhe qytetet e Durrësit. Elbasani, si dhe u shtuan disa pyetje të reja në fletanketë, të cilat na u diktuan nga zhvillimet e fundit, siç është rasti i pyetjes për tekstet e Mediatel-it. Për efekt të një studimi më të thelluar, në anketimin e sivjetëm, u shtua edhe "Fokus-grupi" me studentë e pedagogë, përmes të cilit mund të realizohet ballafaqimi i opinionit të gjerë publik me një opinion më të kualifikuar. Puna është në fazën përfundimtare kur janë regjistruar rezultatet e 1300 të anketuar dhe po bëhet përpunimi i tyre sipas metodave të njohura në raste të tilla. Dukë shfrytëzuar edhe përvojën e vitit tjetër, Këshilli i Ankesave me mbështetjen e KKRT-se po punon për të realizuar një tryezë të rrumbullakët me pjesëmarrjen e institucionave të interesuar drejtëpërdrejt apo terhorazi për rezultatet e anketimit. Rezultatet e këtij anketimi japin mundësinë për një aktivitet sensibilizues në shkallë të gjerë me temën "Respektimi i normave etiko-morale në median elektronike, problem i të gjithëve". Qëllimi është që entet radiotevizive publike dhe private të krijojnë bordet e tyre të etikës, të cilat të përgjigjen në mënyrë të vazhdueshme për realizimin e parametrave të shprehura në nenin 18 të ligjit 8410, në nenin 43 dhe 38. Një nga problemet më të mprehta që u shfaq në fund të vitit 2002 ka qenë edhe zbatimi i neneve 55/2 dhe 56 për reklamat, të cilat, gjithashtu do të trajtohen në tryezën e rrumbullakët.

Drejtimi tjetër i rëndësishëm i punës së Këshillit të Ankesave, që në fakt përbën punën e përditëshme të këtij institucioni, ka qenë vizionimi i vazhdueshëm i programeve të stacioneve të ndryshme radiotevizive dhe monitorimi i drejtuar i disa emisioneve sipas ankesave që vijnë në këtë institucion. Mund të thuhet që mesatarja mujore e programeve të vizionuara nga Këshilli i Ankesave është rreth 100 orë programe të ndryshme. Ndërsa, sipas ankesave janë vizionuar programe pothuaj për të gjitha stacionet televizive të Tiranës. Në raste të ankesave nga rrethet për stacionet lokale, Këshilli i Ankesave ka kontaktuar direkt në drejtues të këtyre stacioneve si në Shkodër, Burrel.

Vlorë, Korçë, Elbasan etj. Lidhur me ankesat e regjistruara mund të themi se 60% e tyre janë për keqpërdorimet e seksit dhe vetën 9% për dhunën dhe 9% për dinjitetin, krejt ndryshe nga anketa e vitit 2001, që shënon shifra 91,3% të të anketuarve prononcohen për keqpërdorimet e dhunës në ekran dhe 88,1% për keqpërdorimet e seksit. Këto shifra duket se kanë ndryshuar shumë pak edhe në anketën e 2002-shit.

Krahas përvojës së fituar në vazhdim, Këshilli i Ankesave është përballur me probleme të reja, të cilat i ka zgjidhur gjithmonë duke u bazuar në Ligj dhe duke krijuar kështu një përvojë të konsoliduar, që përbën sigurinë për ta kryer funksionin e vet institucional në vazhdimësi. Më specifik ka qenë rasti i ankesave për cenimin e dinjitetit në median elektronike, si ka qenë ankesa e komunitetit të pakicave për figurën e ciganes në një nga programet TV, i cili është zgjidhur me mirëkuptimin ndaj palës ankuese. Specifik ka qenë rasti i reklamave televizive, të cilat hapen një debat të ashpër në shtypin e shkruar dhe në disa nga mediat elektronike private të kryeqytetit. Këshilli i Ankesave e shfrytëzoi këtë rast, gjithashtu, për të sensibilizuar sa qe e mundur më tepër opinionin për përgjegjësinë e operatorëve radiotelevizivë në realizimin e normave etike e morale në programet e tyre.

Problemet etike e morale në median elektronike janë çështje delikate, zgjidhja e të cilave kërkon punë të vazhdueshme, sepse prekin shtresa të ndryshme të popullatës që kanë edhe qëndrime të diferencuara dhe sepse për këtë arsye duhet që vetë operatorët radioteleviziv të kenë gjithmonë parasysh ligjet me të cilët realizohen standartet etiko-moralë të një shoqërie të caktuar në një kohë të caktuar.

#### 4. Administrimi i Frekuencave

Spektri i frekuencave eshte nje pasuri kombetare e kufizuar, perdorimi i te ciles, kudo ne bote realizohet ne baze te kriterave rigorozisht te percaktuara, te cilat jane shkelur sistematikisht, me okupimin arbitrar qe, per fat te keq, vazhdoi te aplikohet edhe gjate vitit 2002 nga disa operatore radio e televizive, .

Aktualisht, te gjithë operatorët radio e televizive, per shfrytezimin e spektrit te frekuencave, paguajne vetem taksat e vendosura nga shteti ne baze te ligjit te taksave Nr.8435, date 28.12.1998, ndryshuar me ligjin Nr. 8840, date 11.12.2001 dhe jo vleren e vertete te shfrytezimit, te cilen, sipas rekomandimeve te organizmave te specializuara nderkombetare, e vendos vete tregu. KKRT, e ndergjegjeshme per gjendjen ekonomike te tregut te transmetimeve radio e televizive, vazhdon te mos vendose detyrime per shfrytezimin e brezit te frekuencave.

KKRT e filloi veprimtarine e vet duke gjetur 82 % te numrit te pergjithshem te operatoreve aktuale ne transmetim. Keta operatore, shumica te perqendruar ne Tirane, perdornin breza frekuencash te okupuara arbitrarisht, disa prej tyre edhe 2 kanale ne te njejten zone mbulimi. Nje shperdorim i tille i spektrit, krijoi veshtiresi per KKRT qysh ne momentet e para te veprimtarise. Pavec kesaj, KKRT, sidomos per brezin e frekuencave per transmetime televizive, nuk trashегоi ndonje studim te plote per mbulimin e territorit shqiptar apo dokument koordinimi me fqinjët, pas viteve '90.

KKRT, e ndodhur perpara faktit te kryer, zgjodhi alternativën e **dhenies** se licencave dhe jo te **mbylljes** se veprimtarive te operatoreve ekzistues.

Ne keto kushte, sidomos ne transmetimet televizive tokesore dhe

1. **Nen trysnine e kerkesave te medha per t'u shpallur operatore televizive kombetare,** (11 kerkesa, per te ndertuar ne territorin e Shqiperise 11 rrjete te vecanta, secili me nje numer te caktuar frekuencash),
2. **Ne mungesen e nje plani kombetar te frekuencave radiotevizive,**

**KKRT vendosi te mbeshtetej :**

- **ne eksperiencen e te gjithë vendeve te Europes Lindore dhe Juglindore, ne te cilat, si dhe tek ne, ne fillim te viteve nentedhjete u licencuan operatore private rtv. Ne keto vende transmetojne nje numur i vogel operatorësh private te licensuar dhe jo me shume se 3 jane operoret kombetare private televizive,**
- **ne rekomandimet e organizmave nderkombetare te specializuara, ne rastin konkret ne REKOMANDIMIN ITU-R BT.1123 "Metodat e Planifikimit per Televizionin tokesor me 625 rreshta ne bandat VHF/UHF" (siç jane sistemet B/G te perdorur ne Shqiperi).**

Ne kete rekomandim, Asamblea e Radiokomunikacioneve te ITU, duke vleresuar,

- a) qe rrjetet e transmetuesave te difuzionit duhet te planifikohen ne menyre te tille qe mbulim i kerkuar i nje zone te sigurohet duke perdorur nje numer minimal frekuencash;

- b) qe teoria e rrjeteve uniforme te transmetuesave eshte e dobishme per projektimin e rrjeteve te rinj te transmetuesave ose per rimodelimin e rrjeteve ekzistues;
- c) qe, edhe kur ekzistojne rrjete te ndertuara mire, prape, per sistemet e reja transmetuese televizive me 625 rreshta, ekziston nevoja e orientimit ne metodat e planifikimit ,

**rekomandon :**

**1. qe metodat e paraqitura ne anekset 1 dhe 2 (te rekomandimit) te perdoren per projektimin e rrjeteve te transmetuesave per planifikimin paraparak te rrjeteve televizive tokesore me 625 rreshta ne brezat (VHF) dhe (UHF).**

Me tej, Rekomandimi thekson se, gjate projektimit te rrjeteve, eshte mire qe paraparakisht te percaktohet strategjia qe do te ndiqet ne zhvillimin e rrjeteve transmetues te nje vendi:

“Disa vende mund te preferojne te kene nje mbulim te plote te zones me nje numer te vogel programesh, te tjere preferojne te sakrifikojne mbulimin total te zones me favorin e ofrimit te me shume programeve ne zonat me popullim me te larte. Ne keto raste, teoria e rrjeteve uniforme mund te perdoret per te dhene disa vlera reference per mbulimin e priteshem. Kjo mund te ndihmoje kur krahasohen rrjetet e ndryshme te vendeve te vecante te cilat kane zgjedhur metoda te ndryshme per te arritur mbulimin e tyre te brendshem.”

Kapitulli 4.2 i ketij Rekomandimi, thekson qe ne brezin UHF *“ne pergjithesi eshte gjetur e mundeshme te sigurohet nje mbulim me tre programe me mbrojtje kunder interferencave ne 99 % te kohes. Ne disa raste psh ne Britanine e Madhe (UK) koha per te cilen arrihet mbrojtja eshte reduktuar ne 95 %, keshtu qe eshte gjetur e mundeshme te sigurohet mbulimi me kater programe.”*

Pra,

- **per te siguruar nje cilesi maksimale per te gjithë operatoret,**
- **per t’i lene RTSH ne dispozicion, sipas ligjit, nje rrjet ne UHF per programin e dyte televiziv,**
- **per te bere te mundur eksperimentimin e transmetimeve digjitale tokesore nepermjet venies ne dispozicion te kanaleve te rekomanduara nga Konferencat Nderkombetare te UIT-it te zhvilluara ne Viesbaden dhe Chester,**

**u vendos qe t’i jepeshin operatoreve private, sipas ligjit, vetem 2 licenca per krijimin e rrjeteve tokesore analoge kombetare, qe sebashku me programin e dyte te TVSH, behen tre programe ne UHF, aq sa percaktohen ne rekomandimin e permendur me siper.**

Perfundimi i studimit dhe projektit perkates te mbulimit **ne kushtet konkrete te Shqiperise**, pra perfundimi i **Hartes se Frekuencave** dhe me pas, **Planit te Frekuencave**, do te tregoje kapacitetet me te sakta te frekuencave per mbulimin e territorit te Shqiperise. Me identifikimin e frekuencave te lira ne te gjithë territorin e Shqiperise, qe eshte ne proces, KKRT do te organizoje procedurat e konkurimit per te

leshuar licenca te reja qofshin keto kombetare, mbase jo me shume se nje sipas eksperiences se Britanise se madhe, e permendur ne Rekomandimin e mesiperm apo rajonale dhe vendore.

## **Operatoret vendore**

Aktualisht ne territorin e vendit operojne 35 operatore radio Fm (2 kombetare 30 vendore 3 perseritesa te programeve te huaja) dhe 60 operatore TV (2 kombetare, 53 vendore, 1 perseritesa te programeve te huaja) perfshire 1 satelitor dhe 5 operatore TV me kabell.

Nga operatoret TV vendore, 18 subjekte, perfshijne edhe Tiranen ne zonen e tyre te licencimit. Disa prej tyre, kane instaluar impiantet e tyre transmetues me nje shtrirje gjeografike me te gjere se territori maksimal i lejuar nga ligji ekzistues per operatoret vendore.

Nje nga shkaqet e fenomenit te zgjerimit te paautorizuar eshte se ndryshimet e fundit te ligjit Nr. 8410, date 30.09.1998 "Per radion dhe televizionin publik dhe privat ne Republiken e Shqiperise", sidomos ndryshimi i nenit 20 (i bere me nenin 7 te Ligjit Nr. 8794, date 10.05.2001 "Per disa ndryshime ne ligjin Nr. 8410, date 30.09.1998 "Per radion dhe televizionin publik dhe privat ne Republiken e Shqiperise" sipas te cilit hiqet kufizimi i operatoreve tv kombetare jane kuptuar nga disa operatore ne menyre te njeaneshme si abrogimi i cdo kufizimi ne llojet e licencave qe leshohen nga KKRT. Per pasoje ata kane proceduar ne zgjerimin e zonave te mbulimit duke instaluar impiante transmetimi ne zona jashte liences, pa bere asnje perpjekje per te ndjekur procedurat e percaktuara nga po ai ligj qe sipas tyre lejon krijimin e nje numri te pakufizuar operatoresh kombetare.

Praktikisht, nje veprim i tille perben vazhdimesine e okupimit arbitrar te brezave te frekuencave, duke e vene KKRT perpara faktit te kryer. Ky fenomen shqetesues, ka krijuar nje situatë te renduar ne administrimin e brezave te frekuencave dhe ne cilesine e transmetimeve.

Pavaresisht nga masat qe ka ndermarre KKRT per te detyruar operatoret qe te zbatojne dispozitat e ligjit dhe rregulloret e KKRT-se, qe jane shkallezuar deri ne mbyllje te impianteve transmetues te pa autorizuar, zgjidhja afatgjate dhe me efektive eshte pare ne forcimin e punes per parandalimin e shkeljeve, perpara se ato te ndodhin. Kjo, se pari eshte realizuar nepermjet sqarimit dhe interpretimit te nenit 7 te ligjit te ri ku percaktohen llojet e operatoreve te transmetimeve radio e televizive.

Permbajtja e nenit 7, nuk duhet te shihet e shkeputur nga dispozitat e tjera te ligjit, sic u intereson ta shohin ate disa operatore. Per keta operatore kriteri i vetem i percaktimit te statusit kombetar, eshte vetem mbulimi i 70% te territorit te Republikes, qe spjegon dhe arsyen pse keta operatore po nxitojne te zgjerojne zonen e tyre te mbulimit me cdo kusht dhe pa kurrfare autorizimi.

Per te shmangur kete konfuzion te krijuar ne interpretimin e ligjit, KKRT gjate gjithë vitit 2002 ka zhvilluar nje pune intensive per te sqaruar e bindur operatoret mbi domosdoshmerine e zbatimit te dispozitave ligjore dhe kushteve te licences, per te

shmangur kaosin dhe per te siguruar zhvillimin normal te tregur te transmetimeve radio e televizive.

Per te siguruar zbatimin e akteve te tij, KKRT duhet se pari te ndertoje tek operatoret bindjen se akti i nxjerre eshte i pakontestueshem. Dhe akti behet i pakontestueshem kur ai eshte zbatim i nje **dokumenti strategjik** te pranuar gjeresisht nga te gjitha palet e interesuara.

Ne kete drejtim, problemi me i diskutueshem eshte problemi i disponibilitetit te brezave te frekuencave per me shume se 4 rrjete kombetare. Ky eshte nje problem thjesht teknik, pa ngarkesa politike. Me perpilimin e Hartes se Frekuencave, KKRT ka hedhur nje hap serioz perpara drejt zgjidhjes se drejte te ketij problemi.

Per te kufizuar ne nje fare mase zgjerimin e paautorizuar te zones se mbulimit, me qellim qe te mos perkeqesohej gjendja e shfrytezimit te spektrit dhe te uleshin interferencat e demshme, pas ezaurimit te njoftimeve, verejtjeve, paralajmerimeve e gjobitjeve, KKRT, ne bashkepunim me policine financiare, ka ndermarre disa sanksione qe shkojne nga gjoba deri ne mbylljen e impianteve te palicencuara. Ne kete kuader jane gjobitur nje numer subjektsh. (**Pasqyra Gjobat**)

Vihet re se gjate vitit 2002 ka renie te dukeshme te rasteve te daljeve ne transmetime pirate, pa licence, tregues ky i veprimit te ligjit, por edhe i rolit te rregullatorit.

Ne pergjithesi, mbulimi i territorit nga operatore te tille (qofte operatoret qe kane patur kete shtrirje para procesit te licencimit, qofte ata qe e kane zgjeruar me pas ate) eshte bere ne menyre diskrete ne te gjitha territorin e vendit, duke instaluar impiante transmetues ne pika me koncentrim te larte popullsie, kryesisht ne qendrat e rretheve me te medhenj si Shkodra, Korca, Elbasani, Gjirokastra, etj. I vetmi kriter i ndjekur ne kete rast ka qene sigurimi i nje audience sa me te larte, me shpenzime minimale.

Kjo praktike ka krijuar nje situatë alogjike qe, ndersa shume prej ketyre operatoreve nuk kane plotesuar detyrimet per mbulim brenda zones se tyre te licencimit, ata jane prezente pothuaj ne te gjitha qendrat e medha te banuara duke lene zona relativisht te gjera pa mbulim. Nje praktike e tille, mund te konsiderohet fitimpruresë per biznesin e subjekteve, por eshte ne kundërshtim me kriteret rregulluese, pasi roli i KKRT eshte qe te orientoje zhvillimin ne menyre qe te mbulohet nje pjese sa me e madhe e popullsisë ne te gjitha territorin e vendit dhe jo te privilegjohej popullsia qe ka fatin te jetoje ne qendrat e medha te banuara.

Tabelat e meposhteme paraqesin te dhenat mbi mbulimin e territorit te Shqiperise nga operatoret vendore radio e televizive. Nga tabela rezulton se zona te tilla si Tirana, Durresi, Fieri, Vlora, Shkodra, Gjirokastra e Korca jane te mbuluara me nje numer te madh programesh te cmetuara nga operatore vendore, ne nje kohe kur zona si Mirdita, Mati Bulqiza, Dibra, Kukesi, Hasi, Tropoja, Puka Leskoviku, Skrapari, Erseka, etj, jane krejtesisht te pambuluara ose te mbuluara pjeserisht. (**Pasqyrat “Gjendja e mbulimit te territorit te Shqiperise me sinjal radio FM dhe sinjal TV**).

## Operatoret Kombetare

Gjate vitit 2002 KKRT ka analizuar disa here ecurine e operatoreve televizive kombetare ne drejtim te zbatimit te planit te mbulimit te territorit te Shqiperise me sinjal televiziv.

Nga analizat e zhvilluara, eshte konstatuar se te dy operatoret televizive te licencuar si televizione kombetare (TV ARBERIA dhe TV KLAN) si dhe operatoret e tjere kane ndertuar rrjetet e tyre me pare se te realizohej licencimi, duke mbuluar pjese te konsiderueshme te territorit, me synim qendrat kryesore te banuara, kryesisht aty ku dendesia e popullsise eshte me e madhe.

Pergatitja e planit te frekuencave per keto operatore u bazua ne gjendjen e gjetur duke kerkuar edhe cdo mundesi per te bere pershtatjen me nje studim te realizuar kohe me pare nga RTSH.

Bazuar ne ligjin "Per radion dhe televizionin publik e privat ne Republiken e Shqiperise" (Neni 20),

*"Mbajtësi i licences per transmetim radioteleviziv kombetar duhet te realizoje mbulimin e mbi 70 % te territorit te vendit. Brenda 6 vjetesh ky mbulim duhet te arrije te perfshije deri ne 90 % te territorit dhe jo me pak se 90 % te popullsise".*

Per te ndjekur zbatimin e detyrimit te mesiperme, per secilin nga operatoret kombetare, ne kushtet e licences ben pjese dhe plani i detajuar i mbulimit per cdo vit kalendarik. Ne planin e detajuar te zgjerimit per cdo vit, KKRT ka parashikuar nje zhvillim gradual e te balancuar te mbulimit ne te gjithë territorin e vendit, duke u kujdesur qe te favorizohen zonat e largeta e me pak te zhvilluara ekonomikisht, ku operatoret lokale e kane veshtire te mbijetojne. Ne fund te cdo viti, te gjithë operatoreve u kerkohen te dhena mbi zbatimin e planit te caktuar te mbulimit.

Por theksojme se jo te gjithë operatoret, perfshire edhe operatoret kombetare, i njohin dhe i zbatojne me korrektese detyrimet dhe rregullat administrative te percaktuara. Prandaj, te dhenat mbi te cilat eshte bere analiza jane bazuar kryesisht nga raportet e inspektiveve dhe te dhenat e Departamenti Teknik te KKRT.

Nga shqyrtimi i te dhenave te grumbulluara te mbulimit, rezulton se te dy operatoret kombetare, deri ne fund te vitit te dyte te licencimit mbulojne perkatesisht TV KLAN **40.91%** dhe TV ARBERIA **27.39 % te territorit te vendit**. Llogaritjet e mbulimit jane kryer, duke marre ne konsiderate nje nivel mesatar marrje te sinjalit televiziv qe siguron nje mbulim cilesor ndersa duke ju referuar nivelit minimal mbulimi eshte respektivisht KLAN **52.8 %** dhe TVA **32.5 %** te territorit te vendit.

Sic shihet nga shifrat e mesiperme, vleresimi per zgjerimin e mbulimit nuk eshte i njejte nga te dy operatoret.

Nderkaq KKRT veren se zgjerimi i zones se mbulimit eshte bere kryesisht ne drejtim te zonave qe kerkojne me pak investime dhe ku ekziston interes per thithjen e reklamave si ne zonat e Ultesires Perendimore, dhe kryesisht zones Gjirokaster – Sarande ku jane perqendruar kompanite e medha furnizuese, duke i u shmangur drejtimeve te shenuar ne licence. Per pasoje nuk jane instaluar transmetuesit e planifikuar per mbulimin

e disa zonave me interes te ulet ekonomik dhe me mungesa te theksuara ne marrjen e programeve dhe te informacionit televiziv, kryesisht ne disa zona veriore e verilindore.

Per sa u trajtua me siper KKRT i ka terhequr vemendjen e te dy operatoreve private kombetare dhe i ka paralajmeruar se shmangia nga detyrimet e licences do te merret ne konsiderate ne fund te periudhes se licencimit gjate rinovimit te licences.

Me poshte paraqitet gjendja e mbulimit te realizuar nga operatoret kombetare radio e televizive:

NR	OPERATORI	ZONA E LICENSIMIT	
		SHTRIRJA	% e MBULIMIT
1	TOP ALBANIA RADIO	REPUBLIKA E SHQIPERISE	87.22
2	RADIO +2	REPUBLIKA E SHQIPERISE	72.11
3	TVA	REPUBLIKA E SHQIPERISE	27.39
2	TV KLAN	REPUBLIKA E SHQIPERISE	40.91

## RTSH

Gjendja e mbulimit te territorit te Republikes me sinjalin e operatorit te vetem publik, Radiotelevizionit shqiptar, eshte respektivisht:

**80,54 % per sinjalin e radios, programi i pare ne FM.** Por ky program transmetohet dhe me vale te mesme duke qene programi radiofonik me mbulimin me te madh ne Shqiperi, mbi 95 % e territorit.

### **73,31 % per sinjalin televiziv**

Por duhet thene se nje numer perseritesash te RTSH jane jashte pune, si rezultat i demtimit, gjate periudhes se tranzicionit, te qendrave ku kane qene instaluar me pare, si dhe nje numer tjetër prej tyre nuk transmetojne ne qendrat e meparshme por ne vende te tjera me te uleta, kryesisht prane shtepive te fshatareve, gje qe ka demtuar karakteristikat e mbulimit.

Gjate vitit 2002 KKRT ne bashkepunim me RTSH kane bere perpjekje per zbatimin e detyrave te caktuara per implementimin e Planit Kombetar te Radiofrekuencave, te miratuara nga Keshilli i Ministrave ne maj 2001. Por, ketu eshte rasti te permendim se **RTSH duhet te heqe dore nga disa praktika te se kaluares, te rishfaqura vecanerisht vitin e fundit, kur perdorimi i frekuencave konsiderohej si ekskluzivitet i RTSH-se. Per cdo impiant te ri, ose riaktivizim te transmetuesave e perseritesave te demtuar gjate periudhes se tranzicionit, per cdo rritje fuqie apo ndryshim te kanaleve e te dhenave teknike te transmetuesave te radios e televizionit, RTSH duhet te njoftoje KKRT dhe te marre miratimin prej saj, sepse te gjitha keto**

ndryshime jo vetem duhet te koordinohen me fqinjet por duhet te pasqyrohen ne Harten Kombetare te Frekuencave per te mos shkaktuar nderhyrje reciproke me operatoret private radiotelevizive. Administrimi i spektrit te frekuencave radiotelevizive, sipas ligjit, eshte eskuzivitet e KKRT.

Plani Kombetar i Radiofrekuencave, i miratuar nga Keshilli i Ministrave, percaktonte lirim, brenda vitit 2002 te brezit 81-88 MHz. Ne kete kanal, kanali C sipas normes se vjeter italiane, i cili eshte i vetmi qe perdoret ne te gjithe Europen, sepse edhe italianet, te vetmit qe e kane pase perdorur kane hequr dore, pasi ky brez nuk i takon me transmetimeve televizive, prej rreth 20 vjetesh. RTSH transmeton programin e tij te pare me ane te nje transmetuesi te vendosur ne malin e Dajtit, i cili mund te konsiderohet njekohesisht edhe transmetuesi kryesor i RTSH dhe qe ka mbulimin me te madh. Sinjali i emtuar nga ky transmetues sherben si sinjal primar per nje numur te madh te perseritesave televizive te RTSH qe mbulojne pjesen me te madhe te territorit te Republikes se Shqiperise.

Nen kete kend veshtrim, zevendesimi i ketij transmetuesi perben nje domosdoshmeri, por dhe investim te konsiderushem per TV publik.

Detyra e percaktuar nga plani kombetar i frekuencave per lirim e ketij kanali, nga ana e RTSH, brenda vitit 2002 nuk eshte realizuar. KKRT e ka theksuar kete detyre ne Raportin Vjetor per vitin 2001 te mbajtur ne Parlament. Ky problem eshte trajtuar edhe ne korrespondencen midis KKRT, Ministrise se Transporteve dhe Telekomunikacione dhe RTSH.

Bazuar ne planin e frekuencave, duke filluar nga Janari 2003 transmetimi ne kanalin C konsiderohet i jashteligjshem. Ne kete rast, KKRT-se i lind e drejta te veproje per mbylljen e ketij transmetuesi, nje mase ekstreme ndaj te vetmit operator publik ne Shqiperi. Rruga me e mundeshme do te ishte zgjatja e afatit te perdorimit te kanalit C edhe per nje periudhe tjeter kohore, e shoqeruar me masa te forta administrative e mbeshtetur ne burime financiare per te siguruar respektimin e ketij afati.

Me poshte paraqitet gjendja e mbulimit te realizuar nga RTSH:

NR	OPERATORI	ZONA E LICENSIMIT	
		SHTRIRJA	% e MBULIMIT
1	RADIO TIRANA	REPUBLIKA E SHQIPERISE	Mbi 95%
2	TVSH	REPUBLIKA E SHQIPERISE	73.31

### Perseritesat e programeve te huaja

Perseritja e programeve te huaja radio po sidomos televizive, eshte nje praktike specifike shqiptare, qe lindi nga nevoja e menjehershme per informacion shumeplanesh (informativ, kulturor, didaktik, etj) qe diktoi hapja e Shqiperise. Ne plotesim te ketyre nevojave, ne shumien e qyteteve kryesore u instaluan nje numer i konsiderushem

transmetuesash me fuqi te vogel qe perserisnin programe te huaja te zgjedhur sipas preferencave subjektive. Tradicionalisht, keta perserites kane qene prone e bashkive apo komunave dhe nuk jane licensuar, **per neglizhencen e subjekteve qe i kane ne administrim.**

Ne keto kushte, por dhe per te lehtesuar punen per perpilimin e Hartes se Frekuencave per transmetime radio e televizive te Shqiperise, qe krijon kushte per vendosjen e rregullit ne perdorimin e spektrit, KKRT ka urdheruar mbylljen e perseritesave te **palicencuar** te programeve radio e televizive. Ne pergjithesi, per zbatimin e ketij urdheri KKRT ka patur mirekuptimin e mbeshtetjen e shume bashkive. Por kjo mbeshtetje ka munguar te jepet nga disa bashki si psh bashkite e Gjirokastrës dhe Korçës.

Me perfundimin e Planit te Frekuencave per transmetime radio e televizive, KKRT do te shqyrtoje dhe kerkesat per instalimin e perseritesave te programeve te huaja dhe bazuar ne kriteret e vendosura, do te leshoje licencat perkatese.

### **Harta e frekuencave**

Këshilli Kombëtar i Radio Televizionit, qe me ligj ka per detyrë administrimin e frekuencave të caktuara për qëllime transmetimi radioteleviziv, nuk ka trashëguar ndonje plan per perdorimin e ketyre frekuencave apo edhe vetem ndonje harte te shperndarjes se frekuencave ne territorin e Shqiperise, nga ERT apo nga organizmat e specializuara ne vartesi te Ekzekutivit qe kane mbuluar per shume vjet telekomunikacionet ne Republiken e Shqiperise.

Me krijimin e KKRT, ndonese pa mjetet e nevojeshme, filloi puna per krijimin e data base-s se okupimit te frekuencave radio e televizive. Fillimisht te dhenat u moren nga dokumentet qe subjektet kishin paraqitur per aplikim. Qe ne fillimet e veprimtarise se vet KKRT hartoi projektet dhe gjeti donatoret per paisjen me infrastrukturen e nevojshme teknike per te realizuar Harten e Frekuencave Radiotelevizive te Shqiperise, duke qene se njohja e sakte e gjendjes do t'i hapte rrugen nje planifikimi te sakte e te pakontestueshem te frekuencave.

Ne vitin 2001 me ndihmen e IREX u sigurua software i hartes digitale te Shqiperise i pajisur me programe per llogaritjet radioelektrike si dhe u trainua personeli i KKRT per perdorimin e ketij software.

Gjate vitit 2002 infrastruktura teknike u kompletua nga qendra e monitorimit te frekuencave qe u realizua kryesisht me financimin e qeverise se Mbreterise se Danimarkes (Projekti DANIDA) dhe me fonde buxhetore.

Me krijimin e bazes se plote materiale, u procedua per perpilimin e Hartes se Frekuencave.

Harte e Frekuencave Radiotelevizive te Shqiperise u realizua si rezultat i zbatimit te **Memorandumit** te neneshkruar midis Prezences se OSBE-se ne Shqiperi, Ambasades se Mbreterise se Danimarkes (Projekti Danida), IREX dhe KKRT.

Ne zbatim te detyrave te percaktuara ne memorandumimin e permendur me siper, KKRT-ja propozoi ligjin për ngrirjen e procesit licensues për transmetuesit e rinj derisa të përfundojë hartimi i planit dhe të rishikohet procesi i licensimit dhe vuri ne dispozicion te specialistit te caktuar nga OSBE specialistet e saj dhe mjetet matese dhe transportuese te nevojshem.

Ne kete menyre u verifikuan ne terren, ne te gjithe territorin e Shqiperise, te dhenat teknike te transmetuesave, te cilat më pas u hodhen në programin kompjuterik të hartës së frekuencave. Rezultati i programit ishte një hartë e vërtetë dhe e verifikueshme e perdorimit te frekuencave ne territorin e Shqipërisë.

Ne hartën e frekuencave pervec pasqyrimin te gjendjes, rekomandohen edhe masat praktike qe duhen ndermarre per disiplinimin e transmetimeve radiotelevizive ne Shqiperi.

### **Objektivat per vitin 2003**

Per KKRT tani fillon nje faze e re e veprimtarise, faza e konsolidimit te institucionit. Kjo diktohet nga domosdoshmeria e zhvillimit te transmetimeve radio dhe televizive ne menyre qe, brenda nje periudhe te arsyeshme kohe, te arrihen standardet europiane. Arritja e standardeve europiane presupozon edhe forcimin e bashkepunimin me organizmat homologe te vendeve te Europes si dhe me organizmat e specializuara nderkombetare.

Me qellim qe te realizohet nje objektivi i tille ambicioz, KKRT ka percaktuar nje strategji te detajuar veprimesh e masash, qe do te ndermerren ne nje afat te caktuar kohor.

Objektivat kryesore do te jene :

- a) Percaktimi i kapaciteteve te lira te frekuencave si ne televizion dhe ne radio ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise,
- b) Koordinimi i frekuencave me administratat perkatese te vendeve fqinje,
- c) Permbushja e detyrimeve teknike te operatoreve, vecanerisht ne drejtim te mbulimit me sinjal te territorit te vendit,
- d) Studimi i futjes se teknologjise digjitale ne transmetimet radio e televizive, percaktimi i menyrave te nxitjes se ketyre sherbimeve digjital,

Ne argumentin e fundit po ndalemi pak me gjate :

Radiotelevizioni eshte nga fushat qe ne shoqerine e sotme ka njohur nje prej hopeve me te medha cilesore ne aspektin teknologjik. Kjo ka ardhur jo vetem si rezultat i rolit te madh te medias elektronike ne informimin dhe argetimin e njerezve por dhe nga politika e vendeve te zhvilluara per te gjetur tregje dhe burime te reja fitimi.

Pas viteve '90 me qindra operatore radiotelevizive ne te gjithe boten i sigurojne transmetimet e tyre nepermjet satelitit dhe ne dy tre vitet e fundit numri i tyre eshte shumefishuar nepermjet shfrytezimit nga ana e tyre e teknologjise digjitale. Pay Tv, ose televizioni me pagese, abonimi ne keto televizione dhe ritransmetimi i tyre nepermjet televizionit kabllor po kthehet ne mjetin kryesor te fitimit te operatoreve radiotelevizive.

Ne kete menyre edhe digjitalizimi i transmetimeve tokesore radio e televizive u vu ne rendin e dites dhe sot pothuajse ne te gjitha vendet europiane kane filluar transmetimet digjitale radio e vecanerisht televizive. Kujtoj ketu, gjithashtu, pjesen me te madhe te

vendeve te Europes Lindore e Juglindore. Per nje periudhe 7-8 vjecare ne pjesen me te madhe te vendeve te Europes te gjitha transmetimet televizive do te jene digjitale. Por nese ne transmetimet satelitore, digjitalizimi ka qene edhe deshire e operatoreve ne transmetimet tokesore digjitalizimi ka qene dhe eshte vullnet dhe imponim i shtetit dhe me pak i operatoreve qe jane ne treg. Kjo per dy arsye :

- Per te perballuar numrin ne rritje te kerkesave per operatore radiotelevizive sepse spektri i frekuencave eshte zene prej kohesh nga transmetimet analoge dhe duke qene resurs i kufizuar nuk lejon futjen ne treg te operatoreve te rinj.
- Per te nxjerre sa me shume fitim nepermjet taksave nga shfrytezimi i spektrit te frekuencave qe eshte pasuri kombetare, sepse 5 deri 6 fishohet numri i operatoreve, pra dhe i programeve televizive.

Se sa shpejt po ecet ne kete drejtim ne bote po jap vetem tre shembuj. Ne SHBA nuk shiten me aparatura transmetuese televizive analoge. Ne Itali cdo operator eshte i detyruar te vere ne funksionim se paku nje impiant transmetues digjital dhe ne asnje postacion te ri nuk mundet te instaloje me aparatura analoge. Ne France qe ne muajin shtator te vitit 2001 u vune ne dispozicion te konkurrenteve 25 rrjete televizive digjitale.

Gjate ketij viti, KKRT do te hartojte dhe strategjine e implementimit te transmetimeve digjitale ne Shqiperi. Por, si ne vendimarrjen e vet ashtu dhe ne propozimet per ndonje ndryshim te mundshem ne legjislacion KKRT do te kerkoje mbeshtetjen e ketij parlamenti te nderuar. Vetem nepermjet implementimit te ketij televizioni ne Shqiperi do te kete vend per te gjitha kerkesat e operatoreve dhe te gjitha atyre qe duan te ndertojne nje televizion.

U zgjatem ne kete drejtim, sepse nga eksperiencia e ketyre viteve jemi te bindur, qe megjithe studimet mbi shfrytezimin optimal te spektrit te frekuencave televizive tokesore do te kete perseri te pakenaqur. Pergjigja ndaj tyre do te jete e thjeshte, si deri tani, kaq mundesi ofron spektri. Megjithate, operatoret te cilet nuk do te kualifikohen si kombetare apo rajonale do te kerkojne te “drejten e tyre”, duke argumentuar qe ky biznes eshte i njejte me bizneset e tjera dhe kush ka para mund t’i vere ne qarkullim per te ndertuar nje televizion. Zgjidhja perfundimtare e ketij problemi do te ishte televizioni digjital.

Ne konkurrence me njeri tjetrin per te siguruar audience sa me te madhe per te realizuar objektivat e tyre komerciale, por ne nje mendje, kur behet fjale per zgjerim te paautorizuar te zones se licencimit dhe per te evituar pagesat e detyrimeve, disa operatore, sidomos operatore televizive, po perdorin gjithfare formash e arsyetimesh per te justifikuar mospagesen e detyrimeve financiare dhe per te shmangur masat e sanksionet qe ndermerr KKRT per te kufizuar fenomenin e okupimit arbitrar te brezave te frekuencave.

Per ta frenuar kete fenomen gjate vitit te kaluar eshte bashkepunuar me organizma te tjera te ngarkuara nga ligji per te mbeshtetur KKRT. Ne kete drejtim mund te themi se eshte arritur nje mirekuptim dhe harmonizim i veprimeve me policine tatimore, e cila

eshte vene ne levizje sa here qe KKRT i eshte drejtuar per zgjidhjen e problemeve te vecanta. Por, ndersa ne nivel qendror ekziston nje bashkepunim i kenaqshem, ne nivel vendor, bashkepunimi eshte i manget. Organet vendore e te policise tatimore akoma nuk e konsiderojne si objekt te punes se tyre mbikqyrjen e veprimtarise se operatoreve vendore radio apo televizive dhe ne disa rrethe ka patur subjekte qe operonin pa kurfare licence, te pashqetesuar nga organet perkatese tatimore.

Per vitin 2003 ne do te kerkojme nga organet tatimore qe te jene ne mbeshtetje te KKRT per te gjitha masat ligjore qe do te ndermarrim, qe nga gjobat deri tek sekuestrimi i paisjeve te paautorizuara.

**REALIZIMI I BUXHETIT TE VITIT 2002, DETYRAT PER VITIN 2003,  
DETYRIMET E OPERATOREVE RTV**

**5. Realizimi i fondeve te buxhetit.**

Per vitin 2002 buxheti ne zerin “Shpenzime operative” dhe “Investime” per Keshillin Kombetar te Radios dhe Televizionit nga 89 **milion** leke te planifikuara eshte realizuar 71.7 **milion** leke ose 80 perqind

Realizimi i shpenzimeve sipas projekteve paraqitet si me poshte

	<b>Plan</b>	<b>Fakt</b>	<b>Dif.</b>	<b>%</b>
			<b>Ne projekt leke</b>	
Shpenzime operative	34	33.8	0.2	99
Investime	55	37.9	17.1	69
- <b>Gjithsej</b>	<b>89</b>	<b>71.7</b>	<b>17.3</b>	<b>80</b>

• **Realizimi i fondeve ne zerin “ Shpenzime operative”**

Plani i shpenzimeve operative ne masen prej 34 milion leke i detajuar ne zera per vitin 2002 u realizuan ne masen 33.8 milion leke ose 99 perqind i detajuar ze per ze si me poshte:

<b>Shpenzimet</b>	<b>Plani</b>	<b>Fakti</b>	<b>diferenca</b>	<b>%</b>
			<b>Ne projekt lek</b>	
1.Pagat e shperblimet e anetareve te KKRT-se	20	19.9	0.1	99
2.Sigurimet shoqerore	3.3	3.3		100

3.Shpenzime te ndryshme	10.7	10 .6	0.1	99
<b>Gjithsej</b>	<b>34</b>	<b>33.8</b>	<b>0.2</b>	<b>99</b>

- **Valuta jo tregetare**

Ne mbeshetje te urdherave perkatese te dala per kete qellim gjate vitit 2002 institucioni yne ka perdorur rreth **7580 USD** te detajuar si me poshte:

Shpenzime per udhetim e dieta	6189
Shpenzime per pagese kuotizacione EPRA	1391
<b>Gjithsej</b>	<b>7580</b>

Kundravlefta ne leke te valutes se pa paperdorur mbeti gjendje per t'u perdorur projekt vitit 2002 ne zerin shpenzime operative.

- **Te ardhurat**

Krahas fondeve buxhetore KKRT ka realizuar te ardhura te cilat jane depozituar ne llogarine tone ne Banken e Kursimeve Dega nr 1 me miratimin e Ministrise se Financave. Te ardhurat e realizuara kane qene pagesat qe kane bere subjektet per pagesen vjetore per licence dhe pagesat per marrjen e licences.Te ardhurat e trasheguara dhe te realizuara per vitin 2002 **deri ne ditën e sotme** jane 45.9 milion leke, ne dispozicion te institucionit tone.

- **Realizimi i fondeve ne zerin Investime**

Realizimi i investimeve ne projekt paraqitet si me poshte

Emertimi	Plan me ndryshime	Fakti	Ne projekt leke
			%
Qender e Levizeshme Kontrolli	18,5	18.4	99.8

TVSH e takes doganore	26,5	19.1	72.2
Paisje zyre	5,0	0.4	
Sistemi i regjistrimit te dhenave	5,0	-	
<b>Shuma</b>	<b>55</b>	<b>37.9</b>	<b>69</b>

### **Paisje zyre**

Gjate vitit 2002 ne kete ze shpenzimesh kemi patur ne dispozicion per te realizuar **5 milion** leke paisje zyre, kur deri ne fund te vitit realizimi eshte 400 mije leke.

Realizimi i fondeve ne zerin paisje eshte e kushtezuar me realizimin e rikonstruksionit te godines se KKRT-se i cili nuk u krye per arsye pronesie me Drejtorine e Pergjitheshme te Doganave.

Sistemi i regjistrimit te te dhenave mendohet te realizohet me donatore faze faze. Dhe jo nga fondet buxhetore.

### **Qender e levizeshme kontrolli**

Shuma e vene ne dispozicion nga buxheti i shtetit prej rreth **18 milion leke** perben **32 perqind** te projektit, ose 125800 USD, ndersa diferenca eshte financim i projektit **Danez DANIDA**, ne shumen prej 267490 USD, nga ana e jone u krye procedura e dokumentacionit konforme dispozitave ligjore per prokurimin e drejtperdrejte te ketyre fondeve duke marre dhe miratimin e institucioneve perkatese.

Qendra e Levizeshme e Kontrollit u morr ne dorezim konforme dispozitave ligjore ne fuqi. Brenda vitit eshte bere dhe likujdimi i detyrimeve ndaj takses doganore dhe TVSH per pjesen e blere nga ana e jone me fondet e buxhetit te shtetit

### **TVSH e Takse Doganore**

Eshte paguar taksa doganore dhe TVSH per “ Qendren e Levizeshme kontrolli” per te gjithë vleren e projektit ne shumen prej 19.3 milion leke; per vleren me te madhe te objektit, prej 267490 USD, donacion, nuk u pagua takse doganore.

- **Dhurimet**

Edhe per vitin 2002 krahas fondeve buxhetore te akorduara nga buxheti i shtetit, mbeshtetje financiare kemi pasur dhe nga donatore te ndryshem si Mbreteria e Danimarkes me projektin Danida dhe IREX PRO Media .Per vitin 2002 kemi pasur gjithsej 284705 USD donacione si me poshte:

Donatori	Ne USD			
	Viti 2000	Viti 2001	Viti 2002	Gjithsej
Projekti DANIDA	30261	3000	267490	300751
IREX PRO Media		32450	17215	49665
<b>Gjithsej</b>	<b>30261</b>	<b>35450</b>	<b>284705</b>	<b>350416</b>

Per vitin 2002 Projekti Danida na financoi ne shumen prej 267490 USD per projektin Qender e Levizeshme Kontrolli ndresa financimi i yne per kete projek ishte ne shumen prej 125800 USD. Ne kuader te Memorandumit te Mirekuptimit te lidhur midis Mbretetise se Danimarkes, OSBE, IREX Pro Media dhe Keshillit Kombetar te Radios dhe Televizionit, dhe grantit te dhene nga Pakti i Stabilitetit, IREX financoi shumen prej 17215 USD per kryerjen e studimit te hartes se frekuencave. **Gjithsej donacionet per vitin 2002 per KKRT-ne kane qene 284705 USD.**

#### Detyrimet e operatoreve rtv

- **Pagesat per licence**

Pagesat per licence vjetore per operoret Radio FM dhe TV per vitin 2002 nga 31. milion e 287 mije leke jane realizuar 30 milion e 373 mije leke ose 97.1 perqind.

Operoret FM kane realizuar pagesat ne masen e planifikuar prej 5.1 milion leke, ose 100 perqind.

Operoret TV kane realizuar pagesat per licence ne shumen prej 25 milion e 258 mije leke nga 26. milion e 173 mije leke te planifikuara ose 96.5 perqind.

- **Pagesat per taksat**

Taksat per sherbimet radio televizive per operoret e trasmetimeve FM dhe TV jane arketuar 9 milion e 862 mije leke nga 15. milion e 239 mije leke te planifikuara ose 64.7 perqind.

Operoret Radio FM kane derdhur detyrimin per taksa nga 1. milion e 588 mije leke te planifikuara ne 1. milion e 400 mije leke ose ne perqindje 88.6

Operatoret TV kane derdhur detyrimin per taksat nga 13 milion e 651 mije leke te planifikuara ne 8 milion e 455 mije leke ose 61.9 perqind.

### Realizimi i detyrimeve te operatoreve

	Pagesat per licence		Dif		Taksat		Ne mije leke	
	PI	Real	Dif	%	PI	Real	Dif	%
Oper . FM	5114.5	5114.5	-	100	1588	1407	181	88.6
Oper TV	26173.3	25258.4	914.9	96.5	13651	8455	5196	61.9
<b>Gjithsej</b>	<b>31287.8</b>	<b>30372.9</b>	<b>914.9</b>	<b>97.1</b>	<b>15239.2</b>	<b>9862</b>	<b>5377</b>	<b>64.7</b>

\* Shih pasqyrat e pagesave te operatoreve RTV nr 1

### Detyrat qe dalin per vitin 2003

Me fondet ne dispozicion te Keshillit Kombetar te Radios dhe Televizionit dhe nga donacionet eshte plotesuar infrastruktura bashkekohore per realizimin e misionit te vet ligjor.

Problem per tu zgjidhur eshte mungesa e ambjenteve te punes mbasi momentalisht KKRT ka ne administrim dy kate te ish hotel "Drinit " e cila eshte prone e Drejtorise se Pergjitheshme te doganave dhe ne keto kushte nuk mund te behet asnje lloj rikonstruksioni.KKRT- disponon aparatura me nje vlere te konsiderueshme.

Per kete problem vashdimisht kemi ngritur shqetesimin tone ne strukturat e larta shtetere por deri me sot nuk kemi gjetur zgjidhje.

- **Analiza e tregut te transmetimeve radio e televizive**

Sipas vleresimeve te shume specialisteve, shqiptare e te huaj, tregu i transmetimeve radio e televizive te Shqiperise paraqitet si nje treg i pazhvilluar, i pabalancuar per te mos thene i deformuar, qe nuk siguron mbeshtetje e nevojshme financiare per mbijetesen e numrit te ekzagjeruar e te pajustificuar te operatoreve, sidomos te operatoreve televizive.

Konstatimi i mesiperm argumentohet duke analizuar ne menyre te pergjithshme elementet e meposhtem ekonomike:

### **1. Te ardhurat**

Te ardhurat kryesore te operatoreve radio e televizive sigurohen kryesisht nga reklamamat. Tregu u reklamave eshte i perqendruar kryesisht ne Ultesiren Perendimore, sidomos ne Tirane e me pak ne Durres. Ekzistojne edhe disa biznese relativisht te fuqishem te stabilizuar ne zonen e Gjirokastrës. Nuk eshte rastesi qe ne zonen e Tiranës dhe ne Ultesiren Perendimore ofron sherbim numri shumica e operatoreve radio e televizive ( 75 % te te gjithë operatoreve radio dhe 71,6 % e operatoreve televizive, perfshire edhe operoret kombetare). Edhe zona e Gjirokastrës konsiderohet si zone e lakmuar nga operoret. Ne kete treg, operoret kombetare jane konkurrentet me te fuqishem, por edhe me te lakmuar, pasi pretendohet qe mbulimi i territorit, dhe per pasoje, edhe efektiviteti i reklamave te transmetuara prej tyre eshte me i madh. Eshte fakt qe kompanite e fuqishme shteterore, por edhe private, si KESH, ALBTELECOM, AMC, VODAFONE, INSIG, perdorin si kriter vleresimi per shperndarjen e reklamave mbulimin me sinjal te territorit. Kjo eshte dhe nje nga arsyet kryesore te kerkesave e presioneve nga shume operatore per t'u shpallur operatore kombetare.

Zhvillimi i pamjaftueshem i ekonomise shqiptare, me potencialin e kufizuar te reklamave qe rrjedh prej tij, eshte faktori kryesor pengues edhe per zhvillimin e nje tregu te konsoliduar te reklamave.

Ne mungese te te ardhurave nga reklamamat e produkteve dhe sherbimeve, shume operatore transmetojne reklama per sherbimet me vlere te shtuar te telekomunikacioneve, perfshire edhe linjat me permbajtje te theksuar erotike.

### **2. Shpenzimet**

Investimi per krijimin e nje rrjeti cilesor transmetimi radio apo televiziv, eshte i konsiderueshem. Shumica e operatoreve, sidomos ata vendore, per te reduktuar investimet, kane instaluar pajisje te perdorura qe nuk sigurojne qendrueshmerine e cilesine e deshiruar te sherbimit. Mbajtja ne gatishmeri dhe riparimi i pajisjeve te perdorura, kerkon angazhimin e mjeteve te konsiderueshme financiare gjate periudhes se shfrytezimit. Eshte fakt se shume nga operoret vendore, sidomos ata te cilet jane licencuar per kater prefektura, per shkak te kostove te larta te investimit dhe mirembajtjes, paraqiten me tregues te ulet mbulimi te zones se tyre te licencimit.

Ne veprimtarine radio e televizive, pervec investimeve per ndertimin e rrjetit e te studiove, investimi kryesor aplikohet ne veprimtarine prodhuese, qe per karakteristikat dhe kerkesat e vecanta ka kosto te larte.

Per shkak te kostove te larta, nje numer shume i kufizuar operatoresh radio e televizive jane ne gjendje te prodhojne apo te blejne programe artistike, filma, evenimente sportive, etj.

Shumica e operatoreve perpiqen te mbajne te uleta shpenzimet e prodhimit duke piratuar programet e stacioneve te huaja apo edhe te vendit. Rastet e proceseve gjyqesore mbi te drejtat e transmetimit te evidentuara vitin e kaluar deshmojne kete konstatim.

KKRT mendon se, si pasoje e forcimit te zbatimit te ligjit nga te gjitha hallkat pergjegjese te shtetit, do te nderpritet piratimi i programeve apo i shkeljes se te drejtave te autorit dhe te proncise intelektuale, nje numer i konsiderueshem operatoresh do te detyrohen te reduktojne kohen e transmetimit, apo te nderpresin transmetimin.

### **3. Pagesat dhe taksat**

#### **Konkluzion**

Kostot e larta te mirembajtjes dhe te prodhimit te programeve, te ardhurat e uleta te siguruara nga tregu i pazhvilluar e i deformuar i reklamave, nuk japin garanci per sigurimin e qendrueshmerise ekonomike te shumices se operatorëve radio e televizive.

Konstatimi eshte se per mbajtjen e veprimtarise, shumica e operatorëve radio e televizive **perdorin te ardhura nga veprimtari te tjera qe nuk kane lidhje me veprimtarine radio apo televizive.**

Mendojme se ky eshte shkaku qe operatorët hezitojne te paraqesin ne KKRT bilancet vjetore te aktivitetit financiar, sic percaktohet qarte ne nenin 48 te ligjit “ Per radion e televizionin publik e privat ne Republiken e Shqiperise”.

Nga te dhenat e pakta rezulton edhe formalisht se shumica e operatorëve kane nje bilanc financiar vjetor me humbje ose me nje rezultat minimal pozitiv, qe forcon dyshimet tona se operatorët radio e televizive financohen nga burime jashte aktivitetit per te cilin jane licencuar. Nje situatë e tille krijon mundesi per financime te paligjeshme dhe per perdorimin e mediave per perpunimin e opinionit ne favor te grupeve te caktuara.

Te nderuar deputete,

Viten e fundit dhe kohet e fundit nga politikane si dhe nga disa media ka patur qendrime, opinione dhe komente per Keshillin Kombetar te Radios dhe Televizionit dhe vecanerisht per personin tim.

I obliguar moralisht dhe ligjerisht, me lejoni te spiegohem si me poshte:

1. Keshilli Kombetar i Radios dhe Televizionit u krijua tre vjet me pare ne nje terren krejtesisht te zbrazet: pa ambiente dhe paisje zyre; pa asnje akt, studim a plan frekuencash rtv te shkruar vec ligjit, pa staf teknik e administrativ, pa pervoje, nderkohe qe nje numer operatoresh rtv te palicencuar kishin dale ne transmetim.

- Ne harkun e disa muajve u perzgjodh me konkurs personeli, u hartuan e miratuan rregullore, kritere e procedura te nevojshme per licensimin.
- Jane realizuar, shumica me donacione, disa projekte te infrastruktures, te domosdoshme qe KKRT te kryeje misionin sipas Ligjit: Qendra e Levizshme e Kontrollit te Frekuencave, kryesisht donacion i Qeverise Daneze; Qendra e Monitorimit te Programeve; Harta kompjuterike dixhitale e Shqiperise, donacion i Institutit amerikan IREX. Tashme kemi gati Harten e Frekuencave per Transmetime Radiotelevizive, sipas Memorandumit te Mirekuptimit te nenshkruar midis KKRT dhe donatoreve OSBE/Shqiperi, IREX/Shqiperi dhe DANIDA/Shqiperi. Mbi kete baze, **jemi duke pergatitur Planin e Frekuencave per Transmetime Radiotelevizive**, qe do te perbeje politiken e shtetit ne kete fushe.

Prej disa muajsh KKRT ka hapur faqen e vet ne internet.

- Brenda nje periudhe relativisht te shkurter u shqyrtuan aplikimet dhe u licensuan, jo u lincuan, mbi 100 operatore private radio e televizione, sepse, edhe per vleresimin tim e te KKRT-se, mediat e pavarura jane mushkeria e cdo demokracie, aq me teper per demokracite e brishta.
  - Prej janarit 2002 vazhdon ne menyre sistematike, konform ligjit, monitorimi i programeve dhe raportet mujore publikohen rregullisht.
  - KKRT ka propozuar dhe Kuvendi i Shqiperise ka miratuar uljen e detyrimeve financiare, taksat per frekuence dhe pagesat e licences, duke i lehtesuar operatoret radiotelevizive nga barrierat fiskale.
2. Veprimtaria e KKRT eshte mbikqyrur apo kontrolluar nga organizma te shtetit te ngarkuara me ligj dhe nga organizma nderkombetare qe monitorojne proceset demokratike ne Shqiperi:
- Ne raportin e Kontrollit te Larte te Shtetit, pas kontrollit per veprimtarine ekonomiko – financiare te KKRT per vitet 2000 – 2001, nuk konstatohet asnje dem ekonomik i shkaktuar nga keqperdorimi i vlerave, perfshire dhe administrimin e donacioneve, apo nga procedurat e prokurimeve te fondeve publike.
  - Raportet e ODIHR-it dhe OSBE-se per zgjedhjet e viteve 2000 dhe 2001 e gjejne qendrimin e KKRT per monitorimin e mediave elektronike ne perputhje me ligjin.

- Ne raportet per vitet 2000 dhe 2001 te Departamentit te Shtetit, te Amnesty International dhe te Human Rights per te drejtat e njeriut dhe lirine e informimit ne Shqiperi, per KKRT nuk jepet asnje rast shkeljeje, si permenden bie fjala, organet e rendit, partite politike, organet e drejtesise, apo qofte edhe KQZ dhe vete mediat.
- Nga Komisioni Parlamentar per Mjetet e Informimit Publik nuk ka ndonje raport ose praktike shkresore, ne te cilen t'i terhiqet vemendja KKRT per shkelje te ligjit.
- Gjate gjithë procesit te licencimit nuk ka vendim gjykate qe te hedhe poshte vendimmarrjen e KKRT per shkelje te ligjit apo diskriminim te operatoreve e interesave te tyre.

3. Mediat elektronike ballafaqohen ende me shume probleme. Ato, megjithese ne zhvillim te vrullshem, nuk jane te konsoliduara, vuajne nga mungesa e pervojes dhe e profesionalizmit ne standartet programore dhe ne menaxhim. Veshtiresite financiare i bejne te kerkojne suporte, sidomos nga politika, duke u perdorur reciprokisht, ne dem te paanesise se informacionit dhe te besueshmerise se transmetuesit.

4. Rregullimin e veprimtarise radiotelevizive KKRT e ka trajtuar si nje proces ne zhvillim, duke e pare median jo thjesht si nje industri e biznes, por edhe si percjellese e fjales se lire dhe demokratizimit drejt nje shoqerie te se drejtes.

Toleranca e treguar brenda hapsires qe lejon ligji, njelloj per te gjithë, duke perdorur kryesisht sanksionin e paralajmerimit, nuk duhet kuptuar si mungese vullneti per te zbatuar ligjin.

Nderkaq, interesi i politikës per akses ne media jashte cdo standarti te parashikuar ne ligj, e kthen shpesh ate ne avokate te shkelesve te ligjit, duke u dale ne mbrojtje operatoreve qe identifikohen per informacione te njeanshme, qe piratojne programe, apo qe shkelin kushte te tjera teknike e programore te licences.

Praktika te tilla inkurajojne shkeljen e ligjit dhe cenojne autoritetin e rregullatorit.

5. E krijuar si organ kolegjal vendimmarrës ne klimen e politikave konfliktuale, kur opozita i kishte bojkotuar institucionet, madje edhe Kuvendin, KKRT mund te kete probleme te diskutueshme te kompozimit e te perfaqesimit adekuat sipas raportit pozite – opozite, madje nje vend eshte ende vakant.

Vendimet e KKRT-se, pavaresisht nga kompozimi i ketij organi e nga kush jane propozuar anetaret e tij, gati te gjitha jane votuar ne unanimitet. E shikoj kete si nje akt emancipimi te secilit ne vecanti, qe e pershendes, por edhe si shprehje e konsolidimit te institucioneve, tashme nje proces pa kthim.

**Vendimet e KKRT – rregullator i nje veprimtarie specifike si media, kur nuk rrezohen nga gjykata, eshte e domosdoshme te mbeshteten mundesisht nga ligjvenesit e cdo krahu politik qofshin ata,** sepse zbatimi i ligjit s'ka te beje aq me fatin e rregullatorit se sa me zhvillimin e mbare dhe fatin e medias.

Nese aktualisht ndodh qe vendimet nuk ankimohen ne gjykate, por kane vokacion politik, atehere problemi i kompozimit te organit vendimmarrës duhet diskutuar e zgjidhur perfundimisht; sigurisht, me instrumenta ligjore.

6. Per sa me siper, ne raport me funksionin tim dhe pergjegjesite e mia ne KKRT, deklaroj:

Mandatin per funksionin, edhe ne procedure, si kur e pranon, ashtu edhe kur e le, e kam pare dhe e shoh si pergjegjesi morale e vecanerisht si pergjegjesi para ligjit, e jo si privilegj e tapi.

Ju ftoj te nderuar deputete, te miratoni Raportin per t'i hapur rruge zhvillimeve ne veprimtarine e metejshme radiotelevizive, ne nje moment kyc: kthimit perfundimisht tek standartet; standarte ne prodhim e transmetim, ne programe e ne menaxhim, qe ligji te funksionoje plotesisht e qe tranzicioni i gjate te mbetet mesim e kujtim i hidhur.

## **KESHILLI KOMBETAR I RADOS DHE TELEVISIONIT**

Pasqyra nr.1

Pasqyra e detyrimeve te operatoreve private Radio e Televizione  
per vitin 2002

000/leke

Nr.	Emertimi I subjektit	Rrethet	Pagesat per licence	Paguar	Detyrimi	Taksat per frekuence	Paguar	Detyrimi
<b>Radio FM</b>								
1	Radio Top Albania	Tirane	1500.0	1500.0		277.2	277.2	
2	Radio +2	Tirane	1500.0	1500.0		150.0	150.0	
3	Radio 7	Tirane	78.5	78.5		32.5	32.5	
4	Radio ABC	Korce	34.3	34.3		19.2	19.2	
5	Radio Alfa e Omega	Tirane	124.4	124.4		48.0	48.0	
6	Radio Alpo	Gjirokaster	21.5	21.5		7.2	7.2	
7	Radio Boom Boom	Tirane	100.3	100.3		48	48.0	
8	Radio Club FM	Tirane	68.6	68.6		48.0	48.0	
9	Radio me pers. "D.Velle"	Tirane	100.0	100.0		9.6	9.6	
10	Radio Emanuel	Korce	70.8	70.8		24.0	24.0	
11	Radio Fieri	Fier	34.3	34.3		19.2	19.2	
12	Radio Gras	Gjirokaster	14.3	14.3		14.4	14.4	
13	Radio Iliria	Tirane	68.6	68.6		48.0	48.0	
14	Radio Ime	Tirane	42.3	42.3		48.0	48.0	
15	Radio Jon	Vlore	14.3	14.3		24.0	24.0	
16	Radio Koha	Tirane	70.1	70.1		74.4	74.4	
17	Radio Magic Star	Korce	28.6	28.6		19.2	19.2	
18	Radio Ngjallja	Tirane	61.5	61.5		24.0	24.0	
19	Radio Perla	Durres	68.6	68.6		60.0	60.0	
20	Radio Planet	Tirane	42.3	42.3		48.0	48.0	
21	Radio Rash	Tirane	97.3	97.3		60.0	60.0	
22	Radio Ruzvelt	Tepelene	23.6	23.6		7.2	7.2	
23	Radio Saranda	Sarande	21.5	21.5		7.2	7.2	
24	Radio Skorpion	Tirane	148.6	148.6		181.2		181.2
25	Radio Star	Fier	28.6	28.6		19.2	19.2	
26	Radio Stinet	Tirane	42.3	42.3		60.0	60.0	
27	Radio Top Gold	Tirane	131.5	131.5		60.0	60.0	
28	Radio Val'e kalter	Vlore	43.0	43.0		24.0	24.0	
29	Radio e Pare	Mat	4.3	4.3		7.2	7.2	
30	Radio me pers. BBC	Tirane	150.0	150.0		6.0	6.0	
31	Radio Prespa	Korce	16.2	16.2		3.0	3.0	
32	Radio AL-SAT1	Tirane	128.9	128.9		24.0	24.0	
33	Radio Fantasy	Kavaje	36.5	36.5		4.8	4.8	
34	Radio Rock	Tirane	118.9	118.9		30.0	30.0	
35	Radio me pers. Italia	Tirane	80	80		51.6	51.6	
<b>Shuma</b>			<b>5114.5</b>	<b>5114.5</b>	<b>0.0</b>	<b>1588.3</b>	<b>1407.1</b>	<b>181.2</b>
<b>Realizimi ne %</b>		<b>Pagesat per licence</b>	<b>100.0 %</b>		<b>Taksat</b>	<b>88.6 %</b>		

Te dhenat e mesiperme I korespondojne dates 4.2.2003

## OPERATORET PRIVATE RADIO E TELEVIZIVE NE FUNKSIONIM

Ne fund te vitit 2002

### 1. OPERATORET RADIO FM

#### 1.1 Operatore radio te licencuar deri ne 1 Rreth

NR	OPERATORI	ZONA E LICENCIMIT
1	RADIO E PARE	BASHKIA BURREL
2	RADIO IME	QYTETI I TIRANES
3	RADIO JON	BASHKIA VLORE, BASHKIA ORIKUM DHE KOMUNA QENDER VLORE
4	RADIO MAGIC STAR	RRETHI I KORCES
5	RADIO PLANET	BASHKIA TIRANE
6	RADIO PRESPA	KOMUNA LIQENAS
7	RADIO RUZVELT	PJESERISHT RRETHI I TEPELENES
8	RADIO STINET	BASHKIA E TIRANES

#### 1.2 Operatore radio te licencuar deri ne 1 Prefekturë

NR	OPERATORI	ZONA E LICENCIMIT
1	RADIO BOOM BOOM	RRETHI TIRANES DHE DURRESIT
2	RADIO ABC	PREFEKTURA E KORCES
3	RADIO ALPO	PREFEKTURA E GJIROKASTRES
4	RADIO EMANUEL	PREFEKT. KORCE
5	RADIO FIERI	PREFEKTURA E FIERIT (PJES)
6	RADIO NGJALLJA	RR.I TIRANE, RR. DERRES
7	RADIO SARANDA	PREFEKTURA E VLORES (PJES)
8	RADIO STAR	PREFEKTURA E FIERIT (PJES)

#### 1.3 Operatore radio te licencuar deri ne 2 Prefektura

NR	OPERATORI	ZONA E LICENCIMIT
1	RADIO AL-SAT 1	PREFEKTURA TIRANE DHE DURRES
2	RADIO CLUB FM	PREFEKTURA TIRANE, DURRES
3	RADIO ILIRIA	PREFEKTURA TIRANE DHE DURES
4	RADIO OXYGEN	PREFEKTURA TIRANE DHE DURES
5	RADIO PERLA	PREFEKTURA TIRANE DHE DURRES
6	RADIO RASH	PREFEKTU. TIRANE, RR.I DURRES, RR. LEZHE, RR.LUSHNJE
7	RADIO ROCK	PREFEKT. TIRANE DHE DURRES
8	RADIO VAL E KALTER	RR. VLORE (PJES) T PREFEKTURA E FIERIT (PJES)

### 1.4 Operatore radiote licencuar 2 - 4 Prefektura

NR	OPERATORI	ZONA E LICENCIMIT
1	RADIO 7	PREFEKT.TIRANE, LEZHE, DIBER KUKESIT
2	RADIO ALFA DHE OMEGA	PREFEKT. TIRANE, PREFEKT. DURRES (PJES), PREFEKT. FIER (PJES), RR. VLORE
3	RADIO BBC	PREFEKT. TIRANE, DURRES, LEZHE DHE FIER
4	RADIO DW	PREFEKT. TIRANE, DURRES, LEZHE DHE FIER
5	RADIO KOHA	RR. TIRANE, (PJES) PREFEKT DURRES, PREFEKT LEZHE (PJES)
6	RADIO SCORPION	PREFEK. TIRANE, DURRES, ELBASAN, FIER
7	RADIO TOP GOLD	PREFEKT. TIRANE, PREFEKT. DURRES, PREFEKT FIER(PJES) RR. ELBASANIT

### 2. PERSERITESAT E PROGRAMEVE TE HUAJA ME RADIO FM

NR	OPERATORI	ZONA E LICENCIMIT
1	RADIO BBC	PREFEKT. TIRANE, DURRES, LEZHE DHE FIER
2	RADIO DW	PJESERISHT PREFEKT TIRANE, (PJES) DURRES, LEZHE, FIER
3	RADIO ITALIA	QYTETI TIRANE, ELBASAN, SHKODER, KORÇE, VLORE, LIBRAZHD

KKRT - Mbulimi i territorit sipas operatoreve Radio e Televizive ne fund te 2002

**GJENDJA E MBULIMIT TE TERRITORIT TE SHQIPERISE  
ME SINJAL TELEVIZIV  
Ne fund te vitit 2002**

NR	OPERATORI	ZONA E LICENSIMIT		IMPIANTE TE PA AUTORIZUAR		
		SHTRIRJA	% e MBULIMIT	SASIA	ZONA E PA AUTORIZUAR	% e MBULIMIT
1	TV ANTENA JUG	PJESERISHT RRETHI I GJIROKASTRES	27.44			
2	TV ATN 1	PREFEKTURAT, TIRANE, DURRES, ELBASAN DHE FIER	59.68	1		
3	TV BBF	PREFEKTURA E TIRANES DHE RRETHI I DURRESIT	54			
4	TV DARDAN	PJESERISHT PREFEKTURA E ELBASANIT	19.9	1	RRETHET TIRANE, DURRES, KAVAJE DHE KRUIJE	48.51
5	TV DIBRA	BASHKIA E PESHKOPISE	92.3			
6	TV JUNIOR	PREFEKTURAT, TIRANE, DURRES, ELBASAN DHE FIER	8.9			
7	TV KRUIJA	RRETHI I KRUIJES	40.42			
8	TV LEZHA	RR. LEZHE (PJES) RR.I KURBIN RR. SHKODRES (PJES)	23.64			
9	TV SKAMPA	BASHKIA E ELBASANIT	96.9		RR. ELBASAN	30.5
10	TV SOT 7	RR. KORCE, RR. POGRADEC	31.7			
11	TV ASPARAG	QYTETI I RROGOZHINES	99.4			
12	TV 6+1	PREFEKTURA E VLORES	3.9			
13	TV 2000	PREFEKTURA E TIRANES DHE DURRESIT	35.6	2	RRETHI I VLORES	22.15
14	TV 4 +	RRETHI I LUSHNJES	43.87			
15	TV ADRIA 2	RRETHI I TIRANES DHE RRETHI I DURRESIT	42.7			
16	TV ALBA	PREFEKTURA TIRANE, DURRES, FIER DHE LEZHE	16.32			
17	TV AMANTIA	PJESERISHT RRETHI I VLORES	43.17			
18	TV ANTENA NORD	RR.I SHKODER, RR. MALESISE SE MADHE	30.83			
19	TV ARV	RRETHI I POGRADECIT	37.36	1	RRETHI KORCE	20.54
20	TV AVN	RR. I FIER, RR. LUSHNJE T RR. MALLAKASTER (PJES)	32.55			

## KKRT - Mbulimi i territorit sipas operateve Radio e Televizive ne fund te 2002

NR	OPERATORI	ZONA E LICENSIMIT		IMPIANTE TE PA AUTORIZUAR		
		SHTRIRJA	% e MBULIMIT	SASIA	ZONA E PA AUTORIZUAR	
21	TV BAJRAM CURRI	RRETHI I TROPOJES	15.2			
22	TV BALLKAN	PREFEKTURA TIRANE, DURRES, FIER DHE LEZHE	14.01			
23	TV CALVIN	PREFEKT. TIRANE PREFEKT. DURRES	31.21			
24	TV EGNATIA	PREFEKT. TIRANE, DURRES, ELBASAN KORCE	12.48			
25	TV GRAMSHI	RR. GRAMSH (PJES)	7.2			
26	TV JOHANITER	RR. DURRES	67.17			
27	TV KLAUDIANA	RRETHI I PEQINIT	78.18			
28	TV KOMBI	RR. FIER, RR MALLAKASTER, RR. LUSHNJE (PJES) RR. BERAT (PJES)	35.47			
29	TV KRISTAL +	RRETHI I KORCES	22.9			
30	TV KUKESI	PREFEKTURA TIRANE, DURRES, LEZHE DHE KUKES	19.12			
31	TV KUCOVA	RRETHI I KUCOVES DHE PJESERISHT RRETHI I BERATIT	7.4	1		
32	TV LOBI	RRETHI I KORCES	19.7			
33	TV MARGIT	PREFEKTURA E FIERIT	67.86			
34	TV MATI	RRETHI I MATIT	13.06			
35	TV NESER	PREFEKT. TIRANE, DURRES, LEZHE DHE ELBASAN	15.2			
36	TV NEWS 24	PREFEKTURA TIRANE DHE DURRES	37.24			
37	TV ONUFRI	PJESERISHT RRETHI I BERATIT	28.7			
38	TV PIK	QYTETI I TIRANES	100		RRETHET TIRANE, KRUJE, KAVAJE, DURRES, LUSHNJE, FIER, KURBIN, PEQIN	63.20
39	TV PUKA	RRETHI I PUKES	17.6			
40	TV REAL	PREFEKTURA TIRANE, DURRES, LEZHE DHE FIER	38.08	2		
41	TV ROZAFI	PREFEKTURA LEZHE DHE SHKODER	28.58			
42	TV SHKODRA	RRETHI I SHKODRES DHE QYTETI I KOPLIKUT	35.4			
43	TV TEUTA	BASHKIA TIRANE DHE RRETHI I DURRESIT	32.44			
44	TV MIRDITA	RRETHI I MIRDITES	20.4			
45	TV SHIJAK	PREFEKTURA TIRANE, DURRES, ELBASAN DHE FIER	33.8	7	RRETHET SHKODER, GJIROKASTER, KORCE, LEZHE, BERAT DHE VLORE	30.05

## KKRT - Mbulimi i territorit sipas operateve Radio e Televizive ne fund te 2002

NR	OPERATORI	ZONA E LICENSIMIT		IMPIANTE TE PA AUTORIZUAR		
		SHTRIRJA	% e MBULIMIT	SASIA	ZONA E PA AUTORIZUAR	% e MBULIMIT
46	TV TELESPORT	PREFEKURA TIRANE, DURRES, FIER DHE VLORE	16.02	3	RR. SHKODER, ELBASAN, BERAT, LEZHE	34.94
47	TV TOP CHANNEL	PREFEKURA TIRANE, DURRES, FIER DHE VLORE	17.44	4	RR. SHKODER, LEZHE ELBASAN PEQIN	47.49
48	TV KOHA	RRETHI I TIRANES (PJES) PREFEKT. DURRES (PJES) PREFEKT LEZHE (PJES)	4.06	5	RR. SHKODER, LEZHE, ELBASAN, VLORE GJIROKASTER, FIER DHE LUSHNJE	33.4
49	TNSH	PREFEKURA TIRANE DURRES, ELBASAN DHE FIER	74.92	9	RR. SHKODER, LEZHE, KORCE, VLORE, PERMET, TEPELENE, BERAT, GJIROKASTER	35.24
50	TV VIZION +	PREFEKURA TIRANE, DURRES, VLORE DHE FIER	39	5	RRETHET SHKODER, LIBRAZHD, ELBASAN, BERAT DHE GJIROKASTER	26.47
51	TV DRINI	PJES. RRETHI DIBER, PJES. RRETHI BULQIZE	3.08			

*KKRT - Mbulimi i territorit sipas operatoreve Radio e Televizive ne fund te 2002*

**GJENDJA E MBULIMIT TE TERRITORIT TE SHQIPERISE  
ME SINJAL RADIO FM  
Ne fund te vitit 2002**

NR	OPERATORI	ZONA E LICENSIMIT		IMPIANTE TE PA AUTORIZUAR		
		SHTRIRJA	% e MBULIMIT	SASIA	ZONA E PA AUTORIZUAR	% e MBULIMIT
1	RADIO TIRANA	REPUBLIKA E SHQIPERISE	80.54			
2	TOP ALBANIA RADIO	REPUBLIKA E SHQIPERISE	87.22			
3	RADIO +2	REPUBLIKA E SHQIPERISE	72.11			
4	BOOM BOOM RADIO	RRETHI TIRANES DHE DURRESIT	71.35			
5	RADIO 7	PREFEKT TIRANE, LEZHE, DIBER KUKES	25.35			
6	RADIO ABC	PREFEKT. KORCES	37.22			
7	RADIO ALFA DHE OMEGA	PREFEKT. TIRANE, DURRES (PJES), FIER (PJES), RR. VLORE	34.28			
8	RADIO ALPO	PREFEKTURA E GJIROKASTRES	18.1			
